

Përtej Fjalës

Revistë Kulturore Prill 2010

- ❄ Familja, sa afër dhe sa larg saj!
- ❄ Kush ishin gratë më të mira të Universit
- ❄ Silutetat e tyre nëpër botë
- ❄ Pse qan nëna ime?!
- ❄ Kur ora ndal...



*Unë mund të kem një rrugë shumë të gjatë për të bërë,
por nuk kam frikë t'i hedh hapat një e nga një*



Një frymë këndon në barkun tënd, këndon me dhimbje fatin e tij.

Jehona e vogëlushit
vërshej vetëm për
një njeri. Vallë a nuk
e degjon këtë thirrme të mekur?
Ndoshta nuk edegjon sepse diçka ka
zënë e bluan krijesa që do të fshehësh.
Sa vjen edhe intuita e foshnjës arrin
kulmin. Ai që ta prish qetësinë më

pafajësisht parandien ngjyrën e të nesërmes së largët kur gjithçka e
vesh një interes i çmendur dhe truri i çrregulluar nga kjo nis e komplikon
rrethana me të paqenat gjëra. Pastaj kërkon të ndërtojë një urë të
mundshme për të kapërcyer këtë ditë që po jeton. Kënga e foshnjës
të drejtohet ty burim jetëdhënës, mos harro. Përse nuk e do pjellën e
dëshirës tënde të marrë, në fund të fundit përse nuk e do veten tënde
të njomë, të pastër, të panjollësuar. E kuptoj mirë që në shikimin tënd të
ngjirë e në të njëjtën kohë të derdhur hollësisht mbi çdo sipërfaqe të
ftohtë të arsyes, mbi çdo sipërfaqe magnetike të pasionit. Emocione që
duan të asnjansojnë njëri-tjetrin të kanë ngatërruar të tërën e di, të kanë
ndërlikuar keqas me veten të veshur me ndjenjën e vështirë prej vete
magjise ndiesore. Në të vërtetë objektivi që nuk është, veçse një lineare
absolute e lirë, di të shoh vetëm në një drejtim, qoftë edhe të shtrembër.
Shpirt, kjo risi që pret të vijë s'do të jetë kurrsesi gozhdë për plagët e tua.

Gërshetohen sekondat e kësaj jete, Një e dhimbshme e shkuar ndiqet
nga një ekstaze infinitive. Gjykimi i huaj nuk mund të poshtërojë një dorë
që nuk e lë jetën të fiket përkundrazi e ndihmon të ngrihet. Unë jam një
nga ata të shumtët vizitorë të skenës suaj, unë jam edhe gjykimi i huaj.
Diçka dua të them e për më tepër në çdo ndërgjegje të rrënuar do të
doja të që e shkruar. Kambana andaj jehon, të zgjojë me tinguj sa
s'është vonë atë që lutet sinqerisht për një shtysë drejt jetës së
urtisë. Ngjize brenda teje tingullin, të të ndriçojë mendimin. Emrit
të njollësuar prostitutë i bashkëngjitet herë-herë një madhështi.

Të qenit nënë. Të lutem pranojë këtë dhuratë të paçmuar, o
engjëll që pabesimi të përbalti. Rebelimi i të huajve spektatorë
nuk do t'i detyrohej frymës së gjallë që lind e lumturohet se
jeton, do t'i kushtohej guximit tënd për të mohuar atë që
thellë e dashuron.

P. A.

Përmbajtja

Editorial nga Albana Muja	▶ 4	Vatra e çdokujt prej nesh
Përtej fjalës nga G. Leçini	▶ 6	Shpërblimi më i madh
Këndvështrim nga A. Muja	▶ 10	Shkelja e të drejtave të grave në internet
Trokas nga Iris Maçi	▶ 12	Mëmësia, rruga për në parajsë
Vetëm për zemrat nga J. Bakui	▶ 16	Përtej gurëve të varrit
Unë dhe ti nga Enkeleda Rroshi	▶ 18	Përse qan nëna ime...
Përreth një boshti nga Armida Plumbi	▶ 20	Silueta nëpër botë
Njollë nga A. Muja	▶ 24	Gra pa liri
Imazh nga A. Muja	▶ 26	Mesazhi im ... përtej fjalës
Meteor nga Oriola Heta	▶ 28	Autizmi, sfida e shekullit të ri
Thesar nga A. Kurti	▶ 30	Cilat janë gratë më të mira të universit
Unë pyes? nga Armida Plumbi	▶ 35	Vështrim juridik - Planifikimi familjar
Jetë paralele nga Shehide Vojvoda	▶ 36	Gjithçka që dua
Një çast	▶ 42	Kur ora ndal...
	▶ 43	Imoraliteti kulturor në TV e së shtunës

Kryeredaktore: ALBANA MUJA (CIKU)

Redaktore gjuhësore: Prof.dr. Mimoza Gjokutaj

Recensues fetar: AHMED KALAJA

e-mail: pertej_fjales@gmail.com

Organ i Shoqatës Kulturore: FEMRA INVESTIM I FAMILJES

TIRANË-ALBANIA





Datra e çdokujt prej nesh

Vërtitemi rreth vetes tonë, ikim dhe vijmë sërish tek ndërgjegjia jonë, pa trokitur ende mirë në portat e saj të errëta, nga frika se ç'do ndodh me ne po të jemi krejtësisht vetëm.

Kemi frikë, mendojmë dhe e kuptojmë se ... vetëm jemi... bosh, por sa do e çalë që ta ndajmë, thellë në dejet tona rrjedh ai gjaku që na lidh, e na bën ta njohim me patjetër e të kërkojmë të rritemi në gjirin e saj.

Në gjirin e familjes, e asaj vatrës që të mbledh e të ngroh kur bën shumë ftohtë kudo, në atë vatrë që të freskon kur digjesh nga tymi i vetmisë e harresës, i asaj botës së madhe, kur shumëkush të harron e vetëm porta e familjes tënde qëndron hapur tek pret trokitjen tënde të ndrojtur.

Kjo është panoramë më shumë poetike se sa reale e familjes, por e doja një nuancë poetike që ta mbushja shpirtin për të kujtuar familjet tona.

Ku janë ato?

Ku ikën e u zhdukën?

Atanët e vërtetë nuk janë zhdukur ende, por si kortezh i çoroditur po shkojnë drejt humbjes. Me ndërmarjet e fundit të shumëkujt prej qeverive, e shteteve në zhvillim, prej proceseve në rrokullisje më shumë se sa në ngritje, dëgjojmë tek flitet për globalizim, për shumë ndryshime shndërrime, për liri pa fund e pa krye, për tendenca që çdo gjë do ishte e gjetur, e arrirë përveçse familjes, asaj vlere që më së shumti e veçon gjininë njerëzore nga gjinitë e tjera.

Kjo, e cila vjen prej gjakut e ashtit tonë, prej shpirtit e frymës, këtë duan ta çrrënjosin për të ngritur pedestalin e unit të njeriut të vetëm, individualizmit.

Në çdo ndryshim kuptohet se diçka po shkon mirë që në fillimet e tij, por kur bëhet fjala për minimin e kësaj vlere shoqërore e unike siç është mbjellja e dashurisë së njeriut për familjen, për rrënjët e tij tek i ka lëshuar me mëshirën e Zotit, rrënjë të cilat e rrisin atë dhe mbajnë shëndoshë shoqërinë që shpesh e lëkundin marrëzitë e mendjeve njerëzore.

Kushdo mund të flasë për familjen, kushdo mund ta shkërmoqë atë, po askush nuk foli më mirë se vetë Krijuesi i saj për të, kushdo mund ta hedhë poshtë peshën e saj, por asnjëherë besimtari i drejtë, ai që nuk hedh poshtë dhuratën më të shtrenjtë në prehrin e së cilës e ka vënë me shumë kujdes Ai që fal jetë e mirësi.

Dita Ndërkombëtare e Familjes ka sjellë në qendër të vëmendjes mungesat që ka sot shoqëria shqiptare në këtë pikë. Po kështu dihet se është shumë e nevojshme të hartohen politika dhe strategji për nxjerrjen e shoqërisë nga ky proces ku është futur. Në ditën botërore të familjes ngrihen shumë podiume, flitet në rrethe të pakta, sidomos grash, por asnjë lobim, asgjë më tepër deri sa të shikojmë rrënojat nën këmbët tona ose mos më keq dënime që na vijnë plot tmerr e më pas le të kujtohem se ku çaluam.

Më kujtohet kur kam lexuar mbi familjen, vetë fjala "familje"

në gjuhën arabe përdorej pas kuptimit "aille", që në gjuhën arabe kishte kuptimin "varfëri" ose ai për të cilin duhet të kujdesemi.

Kjo gjë më ka mbetur në mendje, kam rrënuar shumë e shumë herë në çdo gjuhë ti gjej kuptimin etimologjik, por askush e asgjë më mirë se ky shpjegim nuk i shkon familjes, bërthamës sonë. Diçka për të cilën duhet të kujdesemi, a ka lajtmotiv më të mirë e të përgjallë që të mban lidhur pas idesë se ti vërtet je "prej njeriu"?

Ndërsa nga aspekti legjislativ kjo fjalë kishte kuptimin "kontratëmes burrit dhe gruas për bashkimin e jetës së tyre, me të cilën formojnë një shoqëri të vogël". Familja në secilën fe dhe secilin rregullim social pranohet si gurëthemel në shoqëri. Dhe Islami shumë më shpesh drejtohet tek rëndësia e familjes. Në Kur'an dhe në thënie profetike takohemi me zakonet që e përpunojnë temën për formimin e familjes në shumë detaje. Marrëdhëniet mes burrit dhe gruas ose mes bashkëshortëve, marrëdhëniet e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, këto marrëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imta. E gjithë kjo ka për qëllim që shoqëria dhe jo vetëm ajo myslimane të ndërtohet mbi themele të shëndosha ndaj edhe islami kudo dhe në çdo kohë ka ftuar për tek familja, tek mirësia e saj dhe tek ushqimi i saj me besim e qëndrueshmëri në të vërtetën. Ku do ketë më mirë se sa rendja pas asaj nga nis fillesa e çdokujt prej nesh.

Zoti i Madhëruar ka bërë që natyra e prindërve të jetë e tillë që të kujdesen ndaj fëmijëve, të jenë bamirës dhe të gatshëm të sakrifikojnë pasurinë, me qëllim kënaqjen dhe rehatinë e tyre. Padyshim që kjo, është gjë shumë e mirë e cila meriton të shpërblehet me bamirësi dhe falenderim nga ana e fëmijëve duke ua kthyer një pjesë të kësaj mirësie dhe duke mos harruar se merita dhe bamirësia më e madhe i përket atij që ua dha i pari këtë mirësi (prindit). Respektimi i prindërve është një fakt që tregon për lidhjen e ngushtë shoqërore, për të cilën Islami ka nxitur pasuesit e tij, e me këtë cilësi muslimanët dallohen nga popujt e tjerë mosbesimtarë.

Familja myslimane krenohet me prezencën e baballarëve dhe nënave mes tyre, veçanërisht kur ata janë në moshë të thyer dhe me shumë fëmijë nipër e mbesa. Babai musliman qëndron në mes fëmijëve dhe nipërve të tij si një mbret në mbretërinë e tij, sillet nga njëra shtëpi tek tjetra, ndërsa familja tek i cili gjenden prindërit e moshuar, krenohet përpara vëllezërve të tjerë, po kështu tërë shoqëria e shikojnë me një sy tjetër duke e nderuar dhe respektuar për shkak të respektit që ky u bën prindërve.

SHPËRBLIMI MË I MADH...

Nga: G. Leçini

Sistemi Islam dallohet nga të gjitha sistemet e tjera.

Zoti ka urdhëruar në Librin e Tij Famëlartë që të ndjekim rrugën e të Dërguarve të mëparshëm duke na thënë: " ... dhe udhëzimin e tyre pasol!" El En'amë: 90 E nuk ka dyshim se të Dërguarit kanë qenë shembull në bindjen ndaj prindërve të tyre.

Nuhu alejhi selam, i është drejtuar Zotit duke i thënë: "Zoti im! Më fal mua, prindërit e mi, atë që hynë në shtëpinë time si besimtarë, të gjithë besimtarët dhe besimtare dhe mos u shtoj tjetër mosbesimtarëve por vetëm se shkatërrim." Nuh: 28

Ibrahimi alejhi selam, ka thënë: "O Zoti im! Më bëj mua që të plotësoj faljen e rregullt të përcaktuar, po kështu bëj edhe nga pasardhësit e mi. Zoti ynë! Ma prano duanë. Më fal mua dhe prindërit e mi si dhe të gjithë besimtarët Ditën që do të bëhet llogaria." Ibrahim: 40-41

Ndërsa për Ismailin ka thënë: "Kështu Ne i dhamë lajmin përgëzues të një djali me durim të madh. Dhe kur ai (I biri) u rrit mjaft sa të ecte me të, ai i tha: O biri im! Kam parë në ëndërr që po të therja ty (duke të bërë kurban për Zotin). Mendo pra si e shikon! I biri i tha: O baba! Bëje atë që je urdhëruar, se do të më gjesh mua në dashtë Zoti, prej durimtarëve." Safatë: 101-102

I Madhëruari për Jahjanë thotë: "O Jahja! Mbahu fort pas Librit të Parë (Teuratit). Dhe Ne i dhamë atij urtësi duke qenë akoma fëmijë.

Dhe (e bëmë atë) të dashur ndaj njerëzve si mëshirë (a siguri) nga Ne, të pastër nga gjunahet dhe ai që i drejtë dhe i devotshëm.

Dhe i përkushtuar ndaj prindërve të tij, e nuk qe as mospërfillës e as i pabindur (ndaj Zotit dhe ndaj prindërve të tij)." Merjem: 12-14

Ndërsa për Isain Zoti i Madhëruar thotë: "Ai (Isai në djep) tha: Me të vërtetë që unë jam rob i Zotit, Ai më ka dhënë mua Librin (Inxhilin) dhe më ka bërë pejgamber. Dhe Ai më ka bërë mua të bekuar kudo që të jem dhe më ka urdhëruar namazin, zekatin sa të jem gjallë.

Dhe të bindur ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë mospërfillës e të mjerueshëm." Merjem: 30-32

Zoti i Madhëruar i ka urdhëruar të gjithë muslimanët, të Dërguarit apo dhe njerëzit e thjeshtë, që t'i respektojnë e t'i nderojnë prindërit. Për vetë rëndësinë që ka kjo çështje i Madhëruari e ka bashkangjitur adhurimin e Tij me bamirësinë ndaj prindërve, falenderimin e Tij me falenderimin e prindërve. Zoti thotë në Kur'an: "Ndërsa Zoti yt ka përcaktuar që ti të mos adhurosh askënd e asgjë tjetër përveç Tij dhe të jesh i përkushtuar ndaj prindërve të tu..." El Isra: 23

"... më falenderoni Mua dhe prindërit tuaj dhe tek Unë është kthimi i fundit." Lukman: 14

Zoti i Madhëruar ka vendosur për prindërit të drejta të shumta për faktin se ata kanë mirësi të mëdha ndaj fëmijëve, i kanë edukuar me moral të lartë dhe në bindje ndaj Zotit, janë kujdesur e janë privuar nga shumë kënaqësi të tyre vetëm për të mirën e fëmijëve.

Prandaj, jep mundin tënd në përkujdesjen e tyre qoftë gjatë kohës që janë gjallë apo edhe pas vdekjes së tyre. Nëse ti vepron kështu, ke zbatuar këshillën e Zotit për ta, ke kënaqur Zotin dhe ata, sepse ti je munduar t'ua kthesh të mirat që të kanë bërë.

Mendo se mirësia e prindërve ndaj teje është më e madhe se çdo mirësi që mund t'ua afrosh atyre, prandaj sado që ti të mundohesh kurrë nuk do të mundesh t'ua shpërblesh mirësitë që t'i kanë bërë ty. Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Zotit ka thënë: "Kurrë nuk e shpërblen djali babain e tij, vetëm nëse e ka skillav e blen dhe pastaj i dhuron lirinë." Muslimi

Një ditë Ibn Umeri pa një burrë që e mbante nënën e tij në krah dhe me të bënte tauafin rreth Kabes. Ky burrë iu drejtua Ibn Umerit dhe e pyeti se a ia kishte dhënë shpërblimin e duhur asaj? Ibn Umeri me qetësi ia ktheu duke i thënë: "As edhe një dhimbje (prerje të barkut) nga dhimbjet e lindjes nuk ia ke shpërblyer, por Zoti të shpërblen shumë për këtë të paktë që po bën." Buhariu

Është detyrë për ty o besimtar të kujdesesh për ta duke zbatuar fjalën e Zotit: "Në qoftë se njërin prej tyre ose të dy i arrin pleqëria dhe ti je ma ta, mos u thuaj atyre ndonjë fjalë pakënaqësie e mosrespekti, as mos e ngre zërin duke u thënë "uf!" Por t'ua drejtohes atyre me

PËRTEJ FJALËS

Familja myslimane krenohet me prezencën e baballarëve dhe nënave mes tyre, veçanërisht kur ata janë në moshë të thyer dhe me shumë fëmijë nipër e mbesa.

Zoti i Madhëruar ka vendosur për prindërit të drejta të shumta për faktin se ata kanë mirësi të mëdha ndaj fëmijëve, i kanë edukuar me moral të lartë dhe në bindje ndaj Zotit, janë kujdesur e janë privuar nga shumë kënaqësi të tyre vetëm për të mirën e fëmijëve.

Asnjëherë mos e ngre zërin tënd mbi zërin e tyre, por mundohu që zëri yt të jetë më i ulëti. Thuaju atyre fjalë të nderuara, të bukura e të buta duke mos lënë mënjane respektin dhe nderimin, duke zbatuar fjalën e Zotit: “E mos u bëj i vrazhdë me ta, por thuaju fjalë të buta.”

shprehje nderuese e me respekt.

Dhe ule mbi ta krahun e nënshtrimit, të mirësisë e të përljes me mëshirë dhe thuaj: Zoti im! Dhuro mbi ta përkujtimin Tënd, siç më rritën mua kur unë isha i mitur.” El Isra: 23-24

Mëso nga Libri i Zotit Tënd, si të sillesh me edukatë ndaj prindërve të tu, duke mos u shfryrë para tyre për ndonjë gjë që e sheh e nuk të pëlqen, e dëgjon apo e nuhat prej tyre, bëj durim duke shpresuar shpërblim, siç kanë bërë edhe ata durim në fëmijërinë tënde si dhe duke zbatuar fjalën e Zotit: “Dhe mos u thuaj atyre “uf!”

Asnjëherë mos e ngre zërin tënd mbi zërin e tyre, por mundohu që zëri yt të jetë më i ulëti. Thuaju atyre fjalë të nderuara, të bukura e të buta duke mos lënë mënjane respektin dhe nderimin, duke zbatuar fjalën e Zotit: “E mos u bëj i vrazhdë me ta, por thuaju fjalë të buta.”

Ata` bin ebi Rabiha pyeti për ajetin e mësipërm dhe tha se ka kuptimin të mos i braktisë.

Mundohu të jesh modest dhe i butë në fjalë dhe në vepra, shikoi me syrin e mëshirës dhe butësisë dhe mos i shiko me mërzë e mendjemadhësi edhe nëse ata të mërzisin. Ur` uete, radij Zoti anhu, për ajetin: “Dhe ule mbi ta krahun e nënshtrimit, të mirësisë e të përljes me mëshirë...” ka thënë: “Nëse të mërzisin, ti mos i shiko me vrazhdësi sepse shenja e parë që shfaqet nga mërzitja është shikimi me vrazhdësi i atij personi që të ka mërzitur.”

Gjithashtu nga e drejta e tyre ndaj teje është dhe shtimi i duarës për ta që Zoti t`i falë, si shpërblim për edukimin tënd në vegjëli. “E thuaj: Zoti im! Dhuro mbi ta përkujtimin Tënd siç më rritën mua kur unë isha i mitur.”

Për shkak të të drejtës së madhe që kanë prindërit, Zoti e ka bërë detyrë respektin e tyre dhe sjelljen në mënyrën më të mirë edhe nëse ato mund të jenë mosbesimtarë. Jo vetëm kaq, por edhe nëse mundohen të të largojnë nga feja e të të hedhin në mosbesim e gjunahe, përsëri kjo nuk i hedh poshtë detyrimet e tua ndaj tyre për mirësi e edukatë. “Por nëse ata të dy përpigën me ty, që ti të bashkosh të tjerë në adhurimin Tim, për të cilët nuk ke asnjë fakt, atëherë mos iu

bind atyre, por sillu me ta në dunja me dashamirësi...” Lukman: 15

Esma radij Zoti anha, thotë: “Në kohën e të Dërguarit të Zotit, na erdhi nëna për vizitë, e ajo donte të mbante lidhjet me mua (nëna ishte mosbesimtare), e unë e pyeta të Dërguarin e Zotit: A t`i mbaj lidhjet me të? Ai tha: “Po, mbaj lidhjet me nënën tënde.” Buhariu dhe Muslimi Nëse mosbesimi i tyre nuk e zhvlerësoka përkujdesjen tënde ndaj tyre, atëherë do të thonim se nëse prindi është thjesht gjunahqar, nuk bëhet fjalë për mos respektimin e tij. Mirëpo ky respektim nuk do të thotë që ti të veprosh gjunahun për t`iu bindur atyre sepse: “Nuk lejohet t`i bindesh krijesës kur thyhet urdhëri i Krijesit.”

Ne kemi edhe rastin e këtij sahabi të nderuar Sa`d ibn Ebu Uekas, i cili kur pranoi Islamin nëna e tij u mërzi dhe e urdhëroi që ta linte fenë Islame, por ky e refuzoi. Atëherë ajo e frikësoi duke i thënë se nuk do të hante e as nuk do të pinte derisa të vdiste nëse ai nuk largohej nga Islami, e kështu arabët do ta shanin se ai e kishte vrarë nënën e tij. Kështu nëna e Sa`dit qëndroi tre ditë pa ngrënë e pa pirë derisa i ra të fikët, një djallë tjetër i saj që quhej Umarek i dha të pijë e më pas ajo filloi të mallkonte Sa`din. E për këtë ngjarje Zoti i madhëruar zbriti ajetin e 15 të sures Lukman: “Por nëse ata të dy përpigën me ty, që ti të bashkosh të tjerë në adhurimin Tim, për të cilët nuk ke asnjë fakt, atëherë mos iu bind atyre, por sillu me ta në dunja me dashamirësi...”

Zoti i Madhëruar na e ka hapur dhe lehtësuar rrugën e mirësisë, e kujt i jepet mundësia t`i ketë të dy prindërit ose njërin prej tyre gjallë, i ka mbetur akoma mundësia e përfitimit të shpërblimit duke i respektuar ata. Kështu lidhja vazhdon të qëndrojë mes fëmijës dhe prindërve nëse ai kërkon mëshirë dhe falje nga Zoti për ta, realizon premtimin e tyre, nderon të afërmit, ruan lidhjet me miqtë e tyre duke arritur në këtë mënyrë kënaqësinë e Zotit dhe kënaqësinë e tyre.

Mbajtja mend e një mirësie dhe mosmohimi i saj që të ka bërë dikush, llogariten si cilësi të mira, e gjithashtu prej cilësive të mira është dhe kthimi i të mirës po me të mirë, por nëse dikush do të të bënte ndonjë të mirë dhe ti

do t`ia ktheje po me të njëjtën mënyrë, përsëri do ta konsideroje veten të paafte për t`ia kthyer mirësinë e bërë, shokut a mikut tënd e vazhdimisht do t`ia kujtoje, sepse ishte ai i pari që ta bëri këtë mirësi, ndërsa përsa i përket mirësive që na i kanë bërë prindërit, duhet ta ndiejmë veten gjithmonë të paafte për t`ua kthyer në të njëjtën mënyrë sado që të mundohemi.

Abdullah ibn Umer na sjell një shembull të shkëlqyer në respektimin e prindërve dhe pas vdekjes, nga fëmija i mirë. Abdullah ibn Dinar tregon se: “Një ditë Abdullah ibn Umer takon dikë në një rrugë të Mekës dhe i jep salam, zbret nga gomari dhe e hip atë në të si dhe i jep çallmën që e mbante në kokë. Ibn Dinari thotë: I thamë atij: Zoti të drejtoftë! Ai është beduin dhe ata njerëz kënaqen me pak. Abdullah ibn Umer na e ktheu: Babai i tij ka qenë mik i Umer bin Hatabit dhe unë kam dëgjuar të Dërguarin e Zotit të thotë: “Respektimi më i madh i prindërve që mund të bëjë dikush është ruajtja e lidhjeve me mikun e babait të tij edhe pas vdekjes së babait.” transmeton Muslimi

Ebu Hurejre radij Zoti anhu, transmeton se i Dërguari i Zotit ka thënë: “Nëse vdes biri i Ademit i ndërpritet puna e tij më përjashtim të tri rasteve: “Sadekaja e vazhdueshme, dija e dobishme me të cilën përfitohet dhe fëmija i hajrit i cili bën dua për të.” Muslimi

Rrespektimi i prindërve pas vdekjes nuk përqëndrohet vetëm në bërjen lutje për ta, por nëse merr vesh se prindërit ose njëri prej tyre kanë borxh agjërimin ia shlyen atë, nëse nuk e kanë bërë haxhin e bën për ta edhe nëse nuk e kanë lënë amanet. Kryerja e këtyre dy shtyllave të fesë për ta e largon përgjegjësinë e tyre pas vdekjes para Zotit dhe ua shton shpërblimin pa ia pakësuar aspak shpërblimin fëmisë që i kryen ato.

Burejdi, tregon se kur ishte ulur pranë pejgamberit, alejhi salam, vjen një grua dhe i tha të Dërguarit: “Unë dhashë sadaka për nënën time një robëreshë mirëpo nëna më vdiq.

I Dërguari i Zotit i tha: “Ti e more shpërblimin, ndërsa robëreshën merrë si trashëgimi nga nëna jote.” Pastaj ajo e pyet: O i Dërguari i Zotit, nëna ime ka pasur një muaj agjërimi pa e agjëruar, a

të agjëroj unë për të? I tha: Agjëro për të. Ajo përsëri i thotë: Nëna ime nuk e ka bërë Haxhin, a ta bëj unë Haxhin për të? I Dërguari i Zotit i tha: Bëje Haxhin për të.” Muslimi

Prindërit tanë kanë shpenzuar shumë pasuri, për ne kur kemi qenë të vegjël për të na gëzuar e kënaqur, pra jepni sadaka për ta (për hir të Zotit por që shpërblimi t`u shkojë atyre, sh.p) sepse kjo gjë u bën dobi atyre.

Nga Ibn Abas, radij Zoti anhu, tregohet se Sa`d ibn Ubades i vdes nëna e ai nuk ishte i pranishëm dhe i tha pejgamberit, alejhi salam: “O i Dërguari i Zotit, nëna ime vdiq dhe unë nuk isha i pranishëm në vdekjen e saj, a i bën dobi asaj dhënia e sadekasë nga ana ime për të? I Dërguari i Zotit i tha: Po. Pastaj Sa`d i tha se: Ji dëshmitar se unë filan vend e jap sadaka për të.” Buhariu

Ashtu siç e ka bashkangjitur Zoti bamirësinë ndaj prindërve me adhurimin dhe falenderimin e Tij, kështu edhe i Dërguari i Tij e ka bashkangjitur mos respektimin e tyre me të bërit shirk Zotit. Nga Ebu Bekrete transmetohet se i Dërguari i Zotit, alejhi salam, ka thënë: “A doni t`ju tregoj për gjunahet më të mëdha? I thamë: Po o i Dërguari i Zotit. Tha: të bërit shok Zotit në adhurim dhe mosrespektimi i prindërve. E siç ishte i mbështetur u ngrit ulur dhe tha: Ruajuni gënjeshtër dhe dëshmisë së rremë.” Aq shumë i përsëriti ato fjalë, derisa thamë: Sikur të pushontel” Buhariu

I Dërguari i Zotit, ka thënë: “Kënaqësia e Zotit është e lidhur me kënaqësinë e prindërve dhe mërzitja e Zotit është e lidhur drejtpërdrejt me atë të prindërve.” Tirmidhiu, dhe Albani e konsideroi të saktë

Një besimtar nga gjeneratat e para muslimane i vdes nëna e ai u mërzi shumë. Një shok i tij po e ngushëllonte duke i kujtuar se ky është caktimi i Zotit. Ai iu përgjigj duke i thënë: “O vëlla kur e kisha nënën gjallë kisha dy dyer të xhenetit të hapura e mund të futesha nga të dyja duke ia dhënë hakun edhe nënës edhe babës, e tani m`u mbyll njëra derë”. Nëse do i shohim prindërit me këtë sy edhe sjellja jonë ndaj tyre do jetë më afër asaj që na urdhëron Zoti dhe i Dërguari i Tij.

Rrespektimi i prindërve pas vdekjes nuk përqëndrohet vetëm në bërjen lutje për ta, por nëse merr vesh se prindërit ose njëri prej tyre kanë borxh agjërimin ia shlyen atë, nëse nuk e kanë bërë haxhin e bën për ta edhe nëse nuk e kanë lënë amanet. Kryerja e këtyre dy shtyllave të fesë për ta e largon përgjegjësinë e tyre pas vdekjes para Zotit dhe ua shton shpërblimin pa ia pakësuar aspak shpërblimin fëmisë që i kryen ato.

SHKELJA E TË DREJTAVE TË GRAVE NË INTERNET

Kur flasim për median si pushtet më vete, themi me të drejtë se ajo njihet si mbretëreshë të saj tashmë gjuan promotore të vlerave, por si në çdo realitet ekzistencial njerëzor dhe jo njerëzor, konkret apo abstrakt ana tjetër e medaljes mbi rolin mediatik të gruas në shoqëri, mënyra se si ajo pozicionohet apo mënyra se si e pozicionojnë është tronditëse.

Pamë zgjerimin e mjeteve të komunikacionit publik dhe të mjeteve të informacionit që arriti kulmin gjatë viteve të fundit e që krijoi zhvillime të mëdha në komunikimin mes njerëzve. Sociologët dhe intelektualët e kanë konsideruar si shumë të rëndësishëm këtë fenomen në të mirë të njerëzve, ndërsa të tjerë informacionin dhe teknologjinë e konsiderojnë si mjetet kryesore të pushtetit në botë.

Padyshim zhvillimet e reja në fushën e informacionit kanë pasur edhe ndikime të shumta positive.



Por nga ana tjetër sipas eksperteve të informacionit nuk mund të injorohen pasojat negative dhe të dëmshme të mjeteve të reja të komunikacionit –sepse indiferenca ndaj këtyre pasojave mund të ketë dëme të pariparueshme për mbarë bashkësinë njerëzore.

Në këtë kuadër shkelja e të drejtave të grave nëpërmjet internetit, ndoshta mundet të jetë çështja ku është neglizhuar më shumë. Në epokën aktuale, megjithëse në pamje të parë u kushtohet rëndësi principeve të tilla si të drejtat e njeriut dhe liria e shprehjes, shkelen vazhdimisht kuadër të tjera të të drejtave të njeriut siç janë liria personale, pozita njerëzore dhe morali i shoqërisë.

Perëndimi akuzon shumë vënde për shkelje të të drejtave të njeriut, sidomos të grave, por studimet e shumta dëshmojnë se është rritur mjaft abuzimi me gratë në mediat perëndimore dhe në site të shumta të internetit.

Në këtë kuadër shumë nga qendrat e degjenerimit dhe prostitucionit në botë shfrytëzojnë internetin për të organizuar trafikun e fëmijëve dhe grave. Dhe me këtë rast reklamojnë edhe mallrat e tyre në internet.

Gratë, si pjesë e madhe e shoqërisë njerëzore mund të luajnë një rol të rëndësishëm dhe ndikues në mirëqenien e bashkësisë njerëzore dhe në fakt konsiderohen si faktori kryesor i progresit të shoqërisë. Si rrjedhim është i domosdoshëm respektimi i pozitës së tyre njerëzore i dinjiteti dhe vlerës së tyre në shoqëri. Por për fat të keq imazhet e turpshme të vajzave në faqet e ndryshme të reklamave të internetit dhe të informacionit publik, përbëjnë shkelje flagrante të dinjitetit të tyre njerëzor dhe të rolit të tyre të vërtetë në shoqëri. Madje arrihet deri atje sa ato të paraqiten si mall në treg, duke ulur shumë poshtë figurën e gruas, ndaj dhe juristët janë të mendimit se kjo

çështje përbën shkelje të të drejtave të grave.

Disa qendra e kompani tregtuese të mallrave apo shërbimit publik anëtarësojnë falas në internet dhe site të tyre gra dhe vajza dhe pas njëfarë kohe për shkak të reklamimit të këtyre grave, këto kompani tërheqin mijëra klientë. Në këtë proces nën tituj të ndryshëm si: miqësia apo gjetja e bashkëshortes virtuale, krijohen lidhje të pashëndosha duke krijuar dhe një klimë shkatërruese në mjetet e komunikacionit publik.

Kjo është edhe faqja tjetër e përbaltur e medaljes që shfaqet frikshëm në kohët e sotme në një nga llojet e mediave. Dhe kjo si për paradoks të rradhës e në një kohë kontrastesh ku vetë fjala "internet explorer"- do të thotë = zbuloj, shfrytëzoj hapësira dijeje pafund (nga folja explorer, fr), pra gjej dhe zbuloj një gamë të madhe mundësish, për të naviguar në botën e informacionit, dijes dhe progresit dhe jo siç shfaqet ky relet i hidhur ku jo vetëm që nuk eksplorohet për diçka njerëzore, etiko-kulturore akademiko-shkencore, por përkundrazi duke parë dhe marrë çdo gjë të servirur në mënyrën më shtazarake të mundshme, bën që edhe nervi kërkues e krijues tek njerëzit të humbasë së funksionuari e rrjedhimisht duke u ndotur pafund në paturpësitë e shfaqura aty dhe duke shkelur e përdhosur figurën e brishtë të gruas, duke e pasqyruar aty si një mall tregu e që i duhet një reklamë e pisët për ta shitur atë. Dhe se kjo figurë fare mirë mund të formësohet ndoshta në figurën e nënës, motrës, apo bashkëshortes a vajzës tënde, e do të ishte kafshatë e hidhur turpi???..... dhe se vërtet kafshatë që s'kapërdihet, është vetë turpi.....

KËNDVËSHTRIM



MEMËSIA, RRUGA PËR NË PARAJSË...

Nga: Iris Maçi

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet : "Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër përveç Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as 'of' (oh), as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaj fjalë të mira (të buta, respektuese). E në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: 'Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.' " (Isra 23-24)

Mëmësia, është një domosdoshmëri jetësore për shoqërinë njerëzore, ajo përmbledh lidhjen shpirtërore me atë shoqërore. Nëna është faktori kryesor në familje, ku fëmija gjen qetësinë, rehatinë e sigurinë e plotë, kur nëna e shtërëngon dhe e përqafton fëmijën me krahët e saj, ai gjen mbështetje e i lëshohet tërësisht asaj në prehër, e kështu atij i largohet çdo frikë apo brengë që mund të ketë.

Fëmijët të cilëve ju është mohuar kjo përkujdesje dhe mbrojtje e nënës, vuajnë nga sëmundje të ndryshme si trupore, shpirtërore e deri edhe mendore.

Duke u nisur nga kjo, islami i ka kushtuar një rëndësi shumë të madhe edukimit të fëmijës e kryesisht femrës që në vegjëli, duke ndaluar të bërit keq apo padrejtësi asaj, apo qoftë edhe duke mos lejuar preferencën e djalit ndaj vajzës, e si kompesim apo kundërpeshë, femrës i është bërë obligim përkujdesja dhe edukimi i fëmijëve ashtu sikurse i është bërë obligim mashkullit, të mbulojë shpenzimet për të dy (nënës dhe fëmijës) si për të ngrënit e veshmbathje, e më pas të dy prindërit së bashku i japin fëmijës edukatën, moralin, të respektuarit etj.

Islami ia ka ligjëruar gruas, ato detyra dhe të drejta të cilat përshtaten me natyrën e saj si femër, me temperamentin, brishtësinë, duke respektuar mënyrën e komunikimit me fëmijën e saj, në mënyrë që ajo të kryejë këtë mision të shenjtë në jetë, që është 'mëmësia', me gjithçka që ky mision përmbledh si gjidhënia, edukimi, përkujdesja e mirëritja. Kështu, që në fëmijëri fillon të bëhet investimi për një shoqëri të konsoliduar dhe me bazë të qëndrueshme vlerash dhe aspiratash humane. E për këtë duhet një kujdes i caktuar dhe mjaft i veçantë në rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Fëmija është si ajo fleta e bardhë, ku nëse bëjmë një pikturë ku të punonim pa finesë, pa dije e pa taktin e duhur, ne nuk mund t'a fshijmë e t'ia nisim nga e para por na duhet që të bëjmë një tjetër të re, ndërsa jetën e një individi – fëmije, nuk e kthejmë dot mbrapsht për t'i dhënë një formë a pamje tjetër. Fëmija është mjaft delikat, i brishtë, naiv dhe ka nevojë të padiskutueshme për forcën, dijen, përvojën e përkushtimin e prindërve.

Zoti i Madhëruar në librin e Tij të shenjtë tregon mbi mardhëniet njerëzore duke vënë dhe kushtet ndërmjet këtyre mardhënieve në mënyrë që në shtëpi të mbizotërojë qetësia, harmonia, lumturia, mirëkuptimi e

respekti i ndërsjelltë mes dy bashkëshortëve, kjo në mënyrë që fëmija të rritet nën ombrellën e këtij ambjenti. Në Kur'an thuhet : " Dhe nga shenjat e Madheshtise se Tij është se për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gruan), që ju të gjeni prehje tek ato, e në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë."

Nuk ka dyshim, se ekziston një lidhje shumë e fortë ndërmjet fëmijërisë dhe mëmësisë. Nëse nuk do të ketë mëmësi nuk do të ketë as fëmijëri, e nëse kjo mëmësi ekziston atëherë është domosdoshmëri që kjo mëmësi të jepet, e për pasojë do të jepet edhe përkujdesje, përkushtim e mbrojtje, e nëse nuk do të ketë fëmijëri nuk do të ketë përcjellje të mëmësisë.

Mëmësia ofron gjithmonë ëmbëlsi gjë me të cilën ajo është krenuar përgjatë gjithë historisë njerëzore, e është po kjo histori që tregon se si kësaj mëmësie i është besuar nga vetë Zoti i Lartësuar, sekret i ndjenjës së përkujdesjes dhe dhembshurisë për të vegjëlit e saj, e duke i mbështjellë ato me krahët e saj ajo u jep dashuri e përkëdheli, e që më pas edhe kur ato largohen për një kohë të gjatë e bëhen madhorë në moshë, ajo përsëri i pret krahëhapur, pa i pakësuar aspak ato ndjenja.

Shmangia nga mëmësia, pra duke mos e kryer rolin që i është caktuar në rritjen e fëmijës, çon në shkatërrim dhe në rrugë të gabuar.

Sa e sa fëmijë kanë humbur freskinë, shkëlqimin dhe humanizmin, sepse kanë humbur përkujdesjen dhe dashurinë e nënës, kjo, nuk do të thotë që të pakësojmë rolin e babait, porse mëmësia lë gjurmë të qarta e të thella të cilat nuk fshihen lehtë nga kujtesa e fëmijës e në veçanti në vitet e para të tij.

Por megjithë këto, mëmësia nuk mund të realizohet veçse me përcimin e hapave të parë që është lindja e fëmijëve, fëmijëria nuk mund të lindë nga boshllëku apo nga asgjëja, pra duhet patjetër nga mëmësia... pra, kemi një lidhje rrënjësore e të domosdoshme midis mëmësisë dhe fëmijërisë. Mëmësia lidhet



gjithmonë me instiktin dhe ky është instikti natyror që gjendet tek çdo grua. Ky instikt i mëmësisë fillon me shtatzëninë e më pas vazhdon me lindjen e fëmijës, e cila është funksioni bazë në ndërtimin e jetës njerëzore. Qëllimi i saj vazhdon me mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijës derisa ai të rritet e të mbushë moshën e pjekurisë.

Pa dyshim se kjo krijesë e vogël e papjekur e pa formuar nuk mund të hedhë hapat e parë në jetë pa ndihmesë, ajo është e pafuqishme dhe e pavetëdijshme që të kontrollojë apo të zotërojë trupin e saj apo qoftë edhe të sigurojë nevojat e saja. Kështu, është instikti i nënës që Zoti i Madhëruar ia ka dhuruar asaj, e cila me anë të dashurisë, përkujdesjes e mbikqyrjes t'a rrisë këtë fëmijë, ku dihet se e gjithë kjo dashuri e përkujdesje e nënës më pas kompesohet apo shpërblehet.

Shumë njerëz mendojnë se femra është krijuar për të qenë nënë dhe se mëmësia është roli i saj i vetëm në këtë botë.

Por jo, mëmësia ka mjaft rëndësi sepse luan një rol edukativ, dhe përgatitor për individin, dhe nuk lë shkas për të dyshuar sepse mëmësia është një misionin i shenjtë, i përcaktuar veçanërisht për femrën, kjo, për t'a respektuar atë.

Nuk mjafton vetëm instikti për ndërtimin e jetës njerëzore, siç është në rastin e kafshëve, kjo është një gjë e vetëkuptueshme dhe e qartë por, roli i saj si nënë e bën të nevojshme këtë si dhe një çështje mjaft delikate. Rëndësia e rolit të nënës ka të bëjë me shumë përgjegjësi

që ajo ka mbi supë, siç janë : gjidhënia e fëmijës, përgatitja e ushqimit, përgatitja për gjumë, ndihmesa në kryerjen e detyrave të shkollës më pas etj...e padysim që të gjitha këto shqetësime e përgjithësi kanë një rëndësi mjaft të madhe për sa i përket përkujdesjes së fëmijës.

Dihe se fëmija nuk rritet vetëm me bukë, apo nuk rritet vetëm me gjërat më jetësore e elementare apo duke e ushqyer vetëm me ndjenjat e nënës, sepse kjo ndjenjë nuk mjafton për të përmbushur të gjithë misionin me largpamësi.

E pra, cili është roli i nënës?

Roli i saj është shumë i rëndësishëm dhe delikat në të njëjtën kohë dhe është një rol që nuk ka përcaktim apo kufinj. Pafundësia e dashurisë dhe e ndjeshmërisë nuk mjafton, por duhet edhe parapërgatitje e individit që është edhe më fisnikja dhe kjo është para të gjithave.

Vlerësim i plotë mbi humanizmin e gruas, domosdoshmëria për t'i hapur asaj horizonte të gjëra të jetës, në mënyrë që personaliteti i saj të kompletohet që të mund të ndërtojë njeriun e ri. Parapërgatitja e nënës do të thotë parapërgatitja e njeriut, si rrjedhojë grua ka nevojë më shumë se të tjerët, që të ketë sukses në shkollën e jetës e gjithçka që ajo përfshin, që të bëhet një nënë e dobishme për të përgatitur më pas një individ të dobishëm.

Kështu mëmësia nuk është vetëm një profesion por ajo është rol, funksion, mision, përgjegjësi e madhe.

KUR LIND NJË BEBE Ç'DUHET TË DËSH



Feja Islame këshillon se një besimtar i vërtetë duhet të lutet për të patur familje e pasardhës të mirë. Këtë gjë e gjejmë edhe në Kuran ku thuhet: "Edhe ata që thonë: "Zoti ynë na bën që të jemi të gëzuar me punën e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit." (Furkan, 74)

Ashtu siç janë urdhëruar fëmijët që t'u binden prindërve të tyre, ashtu edhe prindërit janë të obliguar që t'i respektojnë e t'i zbatojnë detyrat dhe obligimet që kanë ndaj fëmijëve të tyre. Në mesin e detyrave të prindërve kundrejt fëmijëve, krahas dashurisë, trajtimit në mënyrë të sjellshme, dhembshurisë e përkrahjes, duhet të përfshihet edhe kujdesi e edukimi i tyre, rrënjësja e vlerave të mira tek to e kështu me radhë. Le të përmendim disa prej tyre dhe më kryesoret:

E drejta për të jetuar

Në Arabinë paraislame, tek njerëzit ekzistonte një zakon çnjerëzor, siç ishte ai i sakrifikimit të fëmijëve në emër të zotave të tyre, ose i vrisnin duke u justifikuar për gjendjen e keqe ekonomike, varfërinë etj... Ky fenomen i hidhur ndodh edhe sot në kohët moderne në të gjithë botën, ku nga pamundësia për të rritur fëmijë apo në momentin e njohjes së seksit të fëmijës, e vrasin duke e abortuar. Fenomeni i mbytjes apo vrasjes së fetusit që në fazat e para është i ngjashëm me kohën para ardhjes së Islamit, kur vajzat e sapolindura i groposnin të gjalla në dhë. Mbi këtë fenomen kaq çnjerëzor flitet edhe në Kuran: "E kur të pyeten ato vajza të groposura gjallë në dhë, për çfarë mëkati ato janë mbytur?" (Tekvir, 8-9), "Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet për lindjen e vajzës, fytyra e tij priset dhe përbrenda mbushet plot hidhërim që zien. Fshihet nga njerëzit prej së keqes që u lajmërua. E do ta mbajë atë ashtu i përulur apo do ta mbulojë të gjallë në dhë. Sa i keq është gjykimi i tyre!" (Nahl, 58-59) Dhe është pikërisht Islami që e ka ndaluar vrasjen e fëmijëve, duke e deklaruar këtë akt si një mizori e tmerrshme e një krim rrëqethës e të urreyer. Përgjegjësia kryesore për të mbrojtur dhe ruajtur jetën e fëmijëve bie mbi prindërit, e nëse ata i mbysin për shkaqe ekonomike, kjo është një prej mëkateve më të mëdha e që feja islame i ndëshkon. Në Kuran thuhet: "S'ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytin fëmijët e tyre nga mëndjelehtësia e pa kurrfarë dije dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar." (En'am, 140) Një nga sahabet e pyeti profetin Muhamed a.s.: Cili është mëkati më i madh? Profeti iu përgjigj: "T'i bësh shirk Zotit". Pastaj ai e pyeti përsëri: Po pas kësaj? Profeti (a.s.) i tha: "Kur ti vret fëmijën tënd nga frika se mos ai të merr pjesë (hise) nga ushqimi yt".

Zgjedhja e një emri të mirë për të

Pikërisht, me ardhjen e një fëmije në këtë botë, atij apo asaj duhet t'i vihet emër i mirë (musliman). Dëshmi për këtë është fakti se i dërguari i Allahut a.s. i ndryshonte emrat e

turpshëm dhe i nxiste pasuesit e tij të zgjidhnin emra të mirë (për vetet e tyre dhe për fëmijët e tyre). Ebu Derda thotë se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Me të vërtetë në Ditën e Gjykimit do të thirreni me emrat tuaj dhe me emrat e baballarëve tuaj, kështu që vendosni emra të bukur." (Ebu Davudi)

Në fakt, emri duhet t'i vihet pasi t'i thuhet ezani në vesh (d.m.th. ezani në veshin e djathtë dhe ikameti në të majtën). Ebu Raifi thotë: "E kam parë se si Pejgamberi a.s. ia këndonte ezanin në vesh Hasan ibn Aliut në vesh, menjëherë pas lindje së tij. (Ebu Daudi, hadith hasen)

Bërja e akikës për fëmijën

Profeti a.s ka thënë: "Çdo foshnjë është peng i akikës së saj, e cila thetet për të në ditën e shatë të lindjes, atë ditë i vendoset emri dhe i rruhet koka" (Tirmidhiu, hadith hasen)

Aishja transmeton se Profeti a.s ka thënë: "Për fëmijën mashkull theten dy dele, për afërsisht të ngjashme, ndërsa për fëmijën femër thetet një dele."

Bërja synet e fëmijës së vogël mashkull

Ebu Hurejre transmeton se Profeti a.s ka thënë: "Pesë obligime janë që prej lindjes: synetimi, heqja e qimeve nga vendet e turpshme, shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjve, heqja e qimeve nën sqetulla."

Dhënia e gjirit

Kjo është e drejta fillestare që fëmija merr pas lindjes. Kurani fisnik e ka vërtetuar këtë dhe e ka përkufizuar kohëzgjatjen maksimale për të duke thënë: "Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjidhënien, janë të obliguara t'u japin gjë fëmijëve të vet dy vjet të plota..." (Bekare, 233). Kjo ka të bëjë me ata prindër që dëshirojnë ta plotësojnë afatin e dhënies së gjirit.

Pagimi i harxhimeve të fëmijës Allahu xh.sh ka thënë: "Babai i fëmijës do të mbartë harxhimet e ushqimit të nënës dhe të veshjes aq sa është e arsyeshme. Asnjë person nuk do të ngarkohet përtej mundësive të tij." (Bekare, 233)

Përzgjedhja dhe përgatitja: G. Plumbi



Të përjetosh momentin e zbritjes së trupit të pajetë të njërit prej njerëzve më të dashur në stacionin e parë të jetës së pafundme, është shumë pak të thuash që është e vështirë. Ashtu i pafjalë, me lotët që rrëshkasin nëpër faqe pa i komanduar dot ti vështrojnë se si hidhen grushtet e dheut, si të ishin një rebesh breshëri që ka nisur papritur dhe përfundon shumë shpejt.

Nuk di se si do t'a përshkruanin njerëzit e penës këto momente të vështira, por për mua ishin tepër të trishtueshme kur përjetova këto dite hubjen e një njeriu që nuk e dija sa i shtrenjtë ishte për mua. Aq sa mund të them që ka qenë një prej atyre pak momenteve më të vështira të jetës sime të shkurtër.

Nuk më trishtonte vdekja sepse atë e kemi hak dhe e besojmë, por ajo që më trishtonte në ato momente të vështira ishte se ai iku papritur dhe unë s'munda t'i thoja faleminderit, s'munda t'i shprehja mirënjohjen time për kujdesin që kishte treguar ndaj meje, për dashurinë që më kishte falur, për buzëqeshjen që më kish dhuruar, por pse jo dhe për ato ledhatime prindërore që shumë më kishin ndihmuar në ato fillimet e para të largimit tim nga gjiri i familjes për të hedhur hapat e para drejt studimeve të shkollës së mesme.

Fjalët e poetëve nuk mjaftuan,
Lotët e fëmijëve s'kanë mbaruar,
Zëri i zogjve s'ka pushuar,
Haku juaj s'është vlerësuar!

PERTEJ GUREVE TE VARRIT

E duke qëndruar i heshtur para këtij shtrati të mikut tim, në sytë e mi kishte ngelur akoma ngjyra e bardhe e qefinit. Bardhësia e tij shkëlqente saqë më jepte forcë për t'u lutur për këtë shpirt që të shkonte në paradën qiellore i pastër nga gjynahet. Ta pastronte Krijuesi ynë, se mëshira e tij nuk njeh kufinj për besimtarin. Se ishte mëshira e këtij Krijuesi që në fillimet e viteve '90 të na ndriçonte me dritën e besimit, të na lironte nga zinxhirët e robërisë, nga robëria e një sistemi, dictatorial firaonik ne lirin e njohjes se krijusit te vetem. Ishin momentet e par ate njohjes se Allahut i cili është ky, Zoti ynë që na krijoi dhe na solli në këtë jetë për të jetuar dhe po na kthen në varret tona për të na ringjallur para Tij përsëri për të dhënë llogari për këtë jetë.

Prandaj, është ky besim që nuk më trishtoi vdekja, por frika se mos jam njeri mosmirënjohës me mikun tim, i cili ishte bërë banor i këtij shtrati të fundit. Sepse profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë për të) ka thenë: "Kush nuk falenderon njerëzit, nuk falenderon Allahun."

Mirënjohje për kë? Përse?!

Shumë shpejt kujtesa më solli në mendje ato vite kur unë gjeta shokun e parë të singertë në jetën time. Ishte shoqëria më e singertë që kisha njohur, ndoshta kjo për faktin se ajo ishte ndërtuar me baza të shendosha. Shoqëri për hir të Krijuesit, pa pasur në të interesa miskine siç ndodh rëndom në jetën tonë.

Ishte djallë i vetëm e për të u bëra vëlla. Me plot kuptimin e fjalës, vëlla, sepse dhe prindërit e tij më konsideruan të tillë. Më konsideronin si djalin e dytë në atë shtëpi plot lumturi. Aq sa buzëqeshja e babait të tij sot më duket me pranësë, atëherë dhe kjo më shtyn me gjithë forcën e shpirtit tim, i lutem Krijuesit që t'ja buzëqeshë fytyrën e tij në natën e parë të varrit. T'ia ndriçojë dhe zgjerojë shtratin e tij të fundit, e banesën e tij të parë të botës tjetër. Errësirën e varrit t'ia ndriçojë me namazin e sabahut që e falte në xhami. Se ky është prindi im i dytë. E konsiderova si babain tim.

Mund të jetë normale të shkruash për nënën, për dhimjen që të jep humbja e saj, por babai e ka një vend që dhe atë askush se plotëson dot. Për mua ishte sikur më thanë: -Babi të nderroi jetë. M'u ngushtua gjoksi, m'u errën sytë dhe me zë nga thellësia e shpirtit nuk thoja gje tjetër vetëm se: -O Allah, të tutë jemi dhe tek ty do të kthehemi. O Allah, mëshiroje.

Mbasi mbaruan dhe rregulluan dheun, nuk doja të flisja me askënd, por thoja me vete: -Kisha dhjetë vjet që s'te kisha folur, s'te kisha buzëqeshur. Ishim ndarë pas gjithë asaj mirësie që më kishte dhuruar. Nuk po gjeja asnjë aresye

për të justifikuar veten time. Ahhhhhhhhhh, sa do të doja të të isha pranë, të të jepja një gotë ujë! E mbi të gjitha të të thoja: -Faleminderit, për të gjitha.

E në këtë gjendje m'u kujtua një hadith që njeriu në momentin e prehjes në shtëpinë e fundit ka nevojë për lutjen e besimtarëve. Thashë me zë të fortë, por që askush se dëgjoi sepse nuk e nxorra jashtë këtë; kam akoma shanse për t'i shprehur mirënjohjen, të lutem për të, të lutem, të lutem... sepse kjo lutje është lehtësim për shpirtin e tij, i cili u tregua shumë bujar me mua dhe unë s'do t'a harroj, por do të thërras me gjithë forcën e zërit e të penës që në këtë botë ka vërtetë njerëz të thjeshtë, por me një zemër bujare shumë të madhe që njerëzit kanë nevojë për shembuj të tillë.

E ajo që më qetëson sado pak dhe më lehtëson janë fjalët ilaq të profetit të fundit të njerëzimit, Muhamedit, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë për të, i cili ka thënë: Birit të Ademit i shkëputen veprat e mira nga kjo botë, përveç sadakasë së rrjedhshme ...dhe fëmijës së mirë që lutet për të.

Ky hadith më shtyu të besoj e të them se do të jem një djallë i dytë për të bashkë me shokun, vëllain, mikun më të shtrenjtë të jetës sime.

Allahu na bashkoftë në xhenetet më të larta dhe është kjo ditë që më qetëson sadopak ndërgjegjen time që besoj se do të jemi bashkë përherë dhe s'do ndahemi më kurrë! Amin!

E kur njerëzit u larguan, doja të ikja i fundit, por disa lotë të tjerë me dënësë më tërhoqën vëmendjen nga meditimimi im. Pashë që paska dhe të tjerë që janë ndjerë më keq se sa unë dhe e ndjejnë ndarjen nga babai im i dytë. Kjo më vërtetonte edhe më shumë bindjen time se ai kishte qenë i dobishëm dhe për të tjerët. Dhe më shumë që e ndien këtë humbje s'ka dyshim që është vëllai im i shtrenjtë, por mendoj se edhe më shumë është nëna e vëllait tim që nuk di se çfarë të shprehem për atë zonjë të madhe që nuk do mundem dot t'ia shpreh mirënjohjen dhe t'i jem pranë në këtë humbje të madhe për nënën e vëllait tim.

Do më mjaftonte skena e fundit kur u ndava prej tyre pas mbarimit të shkollës, tek më përcolli tek dera dhe me lotë në sy më tha: Bir, mos e harro vëllain tënd sepse ai ty të ka dhe ne na kujto. Këto fjalë më mjaftojnë më shumë se çdo gjë tjetër. Kokën ta puth në shenjë rrespekti e do të jem mirënjohës gjithë jetën...

Nga: J. Bakiu

VETËM PËR
ZEMRAT

Përse qan nëna ime!

Nënë, kjo që unë veproj nuk është mëkat por zbatim me bindje e dëshirë i asaj çfarë Zoti dhe profeti ynë i dashur na e lanë që ta kryejmë. Unë dëshiroj shumë që dhe t'i ta falësh namazin, t'i përulesh Atij që të krijoj, ta falenderosh për të mirat e bebatitë e shumta që t'i dha, t'i kërkossh falje për kohën e humbur e udhëzim për të ardhmen, kërkoj mëshirë për ditën kur do të dalim para Tij me veprat e punët që kemi punuar tani. Mos qaj për mua nënë e dashur, por qaj për Zotin tënd. Në atë faqe që loton syri për Zotin, atë faqe nuk e godet poshtërimi as në dynja e as në ahiret. Përulju, kërkoj falje e mëshirë, lute të të udhëzojë në rrugë të drejt se aty do të gjesh qetësinë e lumturi në jetën e kësaj bote e të botës tjetër. Unë, e shtrenjta ime, e lus Zotin çdo natë, që të na bëjë prej atyre që bëjnë punë të mira, për të fituar kënaqësinë e Tij, e nuk do të ndalem së luturi e as që do të lodhem duke e bërë një adhurim të tillë, se xheneti fitohet me punë e me mëshirën e të Gjithëmëshirshmit. Zoti na drejtohet në Kuranin famëlartë duke na thënë: "Thua: o robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Zotit, pse vërtet, Zoti i fal të gjithë mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!" (Ez Zumer, 53)

Frikësohu o nëna ime nga Zoti e jo nga njerëzit se prej tyre nuk ke dobi. Zoti thotë: "Unë nuk i bashkoj për robin tim dy frika dhe dy kënaqësi, ai i cili më frikësohet në këtë dynja, ai ka për t'u kënaqur në ahiret kurse ai i cili tenton të kënaqet në dynja, ai ka për të mu frikësuar në ahiret". (Had. Kudsî)

Mos të të vijë turp nga krijesat për bijën tënde muslimane por, turpërohu për këtë mendim që të vërtitet në mendje e arsyeto në argumentat që ndodhen kudo. Ja, edhe tani të është dhënë një mundësi tjetër që të mendosh, je në kohë që të përmirësohesh, e mos mendosh se jemi krijuar kot por e kemi një qëllim, një mision.

Zoti është Ai i cili shpesh na ka shpëtuar e na ka përgëzuar me mirësitë që i kemi e po i gëzojmë, a nuk meriton që ta falënderojmë? Ne e falënderojmë dikë për ndonjë nder që na bën e nuk ia harrojmë sa të jemi gjallë e nuk e kujtojmë Zotin e aq më pak ta falënderojmë. Është Zoti, Ai i cili ka qënë shumë i Durueshëm, Mëshirues e Furnizues ndaj nesh, shumë na ka falur, na ka lënë të lirë e na ka mundësuar shumë nga ato çfarë ne i kemi dashur përsëri, përsëri e përsëri na ka lënë që të vazhdojmë. Mirëpo dije se kur të dënon, dënimi i Tij është i dhimbshëm e i fortë. Është e mundur që zemra jote të shërohet, të hapet pas kësaj "sëmundjeje" e të ndjesh kënaqësinë e njohjes e të dashurisë për Zotin tënd që të fali jetën e të dha gjithçka tjetër. Po ka mundësi që kjo të ndodhë e jam e sigurtë për këtë, se Zoti është falës e mëshirues i madh, se Ai e fal atë që i kërkon falje dhe e udhëzon atë që i kërkon udhëzim.

Shiko o nënë, shiko se çpo ndodh jashtë. A mos dëshiron që edhe unë të jem e prishur si ata? A po dëshiron që unë të sillem keq e të mos të respektoj, të zhvishem në rrugë, të vij natën vonë në shtëpi, të mos e ruaj nderin e të jem e pa moralshme?! Të mos e mar miratimin e pëlqimin tënd kur të marthohem, e pse jo të të nxjer jashtë shtëpisë ndonjë ditë, apo kushedi se çfarë tjetër?! Atje jashtë e kanë harruar Zotin, e bota boshe i ka marrë me vete, atje jashtë ajo shoqëri e shprishur këto gjëra më kërkon, më bën të harroj e të mos e zbatoj respektin ndaj teje, më zhyt thelle në zjarr! Jo moj nënë, mos më kërko të bëhem si ata e as t'i mos vazhdo të mendosh keq për mua, për fenë e pastër e të ndritur të Zotit të Lartësuar. Mos më me këto mendime se ato të çojnë në humbje, se koha nuk të pret, se njerëzit po vdesin çdo ditë, ndërsa tani e ke një mundësi të pendohesh dhe duhet

të pendohesh sepse e ke kohën për ta bërë para se zemra të vulozet e të mos keshë më mundësi që të pendohesh, je në kohë që ta zbusësh zemrën, vepro tani.

Drejtoju Zotit se Ai e fal atë që i largohet mëkatit, që ndjen keqardhje për veprimet e tij në të kaluarën, atë që nuk i kthehet më gabimit e që vendos të mos e përsërisë më, ai që ka besim të mirfilltë e që bën punë të mira. E kur ta kesh kuptuar të vërtetën, zemra të thyet kur kujton se çfarë ke bërë, ndërsa sytë të përlegen nga lotët, mëpas gjithmonë flet drejt e mendon mirë për besimin në Zot, ke ndjenja të pastra e zemërbardhë, e dëshiron me një zell të madh që të bësh vepra të mira ndërsa je larg mendimeve dhe veprave të kota. Thuaj o nënë: "O Zoti im. Nuk meriton askush të adhurohet pos teje, Ti më ke krijuar mua dhe unë jam rob i yt, dhe unë do të jem në premtimin Tënd aq sa të kem mundësi, kërkoj të më mbrosh nga e keqja që kam bërë, i pranoj të gjithë të mirat me të cilat më ke begatuar dhe i pranoj mëkatet e mia. Më fal mua se askush nuk i fal mëkatet përveç Teje".

Mua do të më gjejsh gjithmonë pranë, në të mirë e në të keq. Unë do të jem aty kur ty të të marrë malli për të më parë e do të përqafoj ngrohtësisht e nuk do të largohem derisa t'i të ma kërkossh, do të jem çdo mëngjes e mbrëmje në kokën e shtratit tënd kur t'i të zgjohesh e gjer sa të të zërë gjumi, nuk do të largohem prej teje pa të rregulluar shtëpinë, pa të bërë gati bukën, pa të bërë kafënë. Do të jem aty për të të dhënë gotën e ujit kur të të pihet e të ta fërkoj dorën e trupin kur të lodhesh. Do të jem aty duke iu lutur Zotit për ty. Këto o e shtrenjta ime nuk mi mësoi shoqëria e moderuar por jan urdhrat e Zotit e profetit tonë tyë dashur që të jemi të sjellshëm, të kujdesshëm e të respektueshëm ndaj jush.

nga: Enkeleda Rroshi



Nga: Armida Plumbi

Të drejtat e Grave

Tradicionalisht, gratë nëpër botë nuk kanë gëzuar qasje të barabartë në të drejtat themelore të njeriut, mbrojtjen, burimet dhe shërbimet. Për fat të keq, pabarazia gjinore është ende e pranishme në çdo shoqëri dhe mbetet si një pengesë e madhe për botën.

Ndoshta nuk është nevoja që ta përmendim gjendjen e femrës në shoqërinë greke, persiane dhe jehudite, madje edhe shoqëria e krishtere ka pasur një qëndrim të keq ndaj femrës. Në një katadrale është mbajtur një mbledhje për të hulumtuar se femra është thjesht vetëm trup pa shpirt ose trup me shpirt, shumica e mendimeve ishin se ajo është trup pa shpirt përveç Merjemes, nënës së Isait a.s. Në vitin 586 Franca ka mbajtur një konferencë për hulumtimin e çështjes së femrës:

A ka shpirt femra ose jo? Nëse ka shpirt ky shpirt, a është shpirt kafshësh ose shpirt njeriu? Në fund vendosën që ajo është njeri, por e krijuar për t'i shërbyer burrit.

Parlamenti i Anglisë në kohën e Henrit të Tetë ka vendosur që femrës t'i ndalohej të lexojë Biblën, sepse ajo konsiderohej ndytësirë e papastër.

Ligji i Anglisë deri në vitin 1805 i ka dhënë të drejtë burrit që ta shesë gruan e tij, ku vlera e saj kushtonte 6 pensa. Në kohën ku jetojmë femra largohet nga shtëpia pas moshës 18 vjeçare që të fillojë dhe të punojë për kafshatën e gojës në mënyrë që të jetojë dhe nëse dëshiron që të qëndrojë në shtëpi të prindërve duhet që prindërve t'u paguajë qeranë e dhomës, ushqimin dhe larjen e robave të saj. Situata të pabarabarta për gratë ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme sipas rajonit, vendit, kulturës, shoqërisë, komunitetit, etj.

Gjithashtu, ka kushte të ndryshme dhe vende ku gratë janë në disavantazh. Ndonjëherë origjinë e diskriminimit janë besimet e pabaza, traditat kulturore apo interesat politike. Këto arsyeime në disa raste inkurajojnë trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të grave, duke krijuar kështu një bashkësitë shtypur. Përmë tepër kategorizimisipas racës, aftësive të kufizuara, gjendjes ekonomike dhe disa faktorë të tjerë shkaktojnë gjithnjë e më shumë veprime diskriminuese në shoqëri. Në një sistem patriarkal, ku meshkujt janë dominues, ky diskriminim është aq i zakonshëm në shumë shoqëri, por edhe brenda familjeve. Si pasojë, dhuna ndaj grave është parë kryesisht në këto lloje komunitetesh dhe familjesh. Aktet e fundit të dhunës që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave janë: dhuna në familje, përdhunimet, abuzimi seksual, tortura, etj. Disa nga çështjet e tjera zakonisht që kërkojnë të njihen si pjesë e të drejtave të grave janë: integriteti trupor dhe pavarësia, e drejta për të votuar, e drejta për të punuar ose për t'u paguar, e drejta e barabartë për të pasur pasuri, si dhe për të hyrë në kontrata ligjore, edukimi, të drejtat martesore dhe prindërore dhe të drejtat fetare. Kur ne kujtojmë lëvizjen gjinore, në mend na vjen lëvizja feministe për të mbrojtur barazinë gjinore në mënyra të organizuar për qindra vjet që nga mesi i shekullit të 19-të. Feministet perëndimore luftuan për njohjen e grave si "persona", për të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhje ose për të marrë një arsim të avancuar. Më vonë, feministet luftuan për përgjegjësi të përbashkët në punët e shtëpisë të papaguara dhe në rritjen e fëmijëve, për mosdiskriminimin në vendin e punës dhe për të fituar pagesë të barabartë për punë të barabartë, për pavarësinë e grave dhe të drejtat riprodhuese, kujdesin e duhur shëndetësor, si dhe dhënien fund të dhunës ndaj grave. Përmë tepër, feministet janë duke punuar për t'i dhënë fund transformimit të institucioneve patriarkale në komunitete të ndryshme. Sot shumë gra në shumë vende, me anë të pjesëmarrjes në organizata të ndryshme, vazhdojnë të bëjnë punë të rëndësishme në këto fusha. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rrjeteve të ndryshme, zëri i grave ka filluar të dëgjohet më shumë kanë filluar të jenë më efektive në komunitete të ndryshme. Si rezultat ka pasur përpjekje të mëdha ndërkombëtare të përqëndruara në zhdukjen e këtyre pabarazive. Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) është traktati

kryesor ndërkombëtar i të drejtave të njeriut për gratë, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979. Në Konventën CEDAË, është përshkruar shpesh si një ligj ndërkombëtar i të drejtave të grave. Dokumenti i detajuar përcakton se çfarë përbën diskriminim ndaj grave dhe përcakton edhe ngritjen e një axhende për veprim ndërkombëtar për t'i dhënë fund një diskriminimi të tillë.

Të drejtat e nënës në veçanti

Fjala "nënë" i atribuohet edhe një gruaje tjetër që nuk është prindi biologjik, veçanërisht në qoftë se ajo është që plotëson rolin kryesor social në rritjen e fëmijës. Nënata kanë përmbushur historikisht rolin kryesor në edukimin e fëmijëve, por që nga fundi i shekullit të XX-të, rolin të babait në kujdesin e fëmijës i është dhënë rëndësi e madhe dhe është pranuar nga ana sociale në disa vende perëndimore. Roli shoqëror dhe përvoja e amësisë ndryshon shumë varësisht mbi vendndodhjen. Organizata "Save the Children" ka një renditje të vendeve të botës dhe ka zbuluar se vendet skandinave janë vendet më të sigurta për të lindur, ndërsa vendet e Afrikës nën-sahariane janë pak më të sigurta për të lindur. Ky studim ka lidhje me kushtet që mbizotërojnë në këto vende.

Lëvizjet e të drejtave të nënave janë formuar në fusha të ndryshme, duke u fokusuar në çështjet e punës (të drejtat e punës), dhënies së (pirjes) gji dhe të drejtat bazuar në të drejtën familjare. Një numër organizatash, duke përfshirë Organizatën Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), janë duke punuar për të përmirësuar të drejtat e nënave dhe uljen e vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve nëpër botë.

Në kontekstin e së drejtës familjare, çështjet kryesore të identifikuar në këtë fushë janë: siguria e nënave dhe fëmijëve të tyre në rrethanat e dhunës në familje, duke marrë masa mbrojtëse në rast të abuzimit të fëmijëve, rastet e adoptimeve pa lejen e nënës, dhënien e kujdestarisë në raste divorcesh, etj.

Shumë organizata të tjera kanë mbrojtur idenë për leje lindjeje më të gjatë dhe ruajtjen e vendit të punës për këto nëna. Shumica e vendeve lënë garanci të paguar, duke ofruar



shumë më tepër se 3 muaj leje të paguar, SHBA nuk garanton një ditë të vetme të pushimit të paguar.

Islami dhe të drejtat e nënës

Ndër shembujt më të qartë të respektimit të gruas në Islam është statusi i madh që i jepet nënës. Islami urdhëron mirësi, respekt dhe bindje ndaj prindërve dhe në mënyrë specifike thekson dhe i jep përparësi nënës. Islami i ngre prindërit në një status më të madh se në çdo legjislacion, fe tjetër apo ideologji. Zoti thotë: *"Adhuronit Zotin e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjëve të afërt, ndaj fqinjëve të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. Zoti nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet."* [Nisa,36] Përmendja e bindjes ndaj prindërve vijon menjëherë pas bindjes ndaj Zotit. Kjo është e përsëritur gjatë gjithë Kur'anit.

"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve."

Sa i përket ndërrimit të këtyre të drejtave nëpërmjet kohërave, nuk kanë ndryshuar në aspektin e parimeve të rënjosura teorike, por në atë praktike. Sa i përket aspektit praktik nuk ka dyshim se koha e artë e islamit (gjenerata e artë), muslimanët ishin më shumë praktikues të sheriatit të Zotit të tyre dhe prej dispozitave të jurisprudencës ishte: Bindja ndaj prindërve, bamirësia ndaj bashkëshortes, vajzës dhe motrës dhe femrave në përgjithësi. Sa më shumë që të dobësohej feja ndodhnin defekte ose probleme në praktikimin e këtyre të drejtave, mirëpo vazhdon të jetë një grup deri në Ditën e Fundit që i përmbahet fesë dhe e praktikon ligjet e Zotit të kësaj feje, këta janë ata të cilët e nderojnë femrën dhe ia japin të drejtën e saj. Megjithatë dobësimin e fesë te disa prej muslimanëve në kohën e sotme femrës i ngelet vendi dhe pozita e saj si, nënë, vajzë, bashkëshorte, motër, megjithatë mangësitë dhe padrejtësitë dhe lënia pas dore e të drejtave të saj tek disa prej njerëzve.

Gruaja është mësuesi i parë dhe më i shkëlqyer i fëmijëve, sepse ndër detyrat më të rënda dhe më me përgjegjësi në botë është rritja, kujdesi, edukimi dhe arsimimi i fëmijës si dhe formimi i personalitetit të tij. Atëherë a mund të mendohet që këtë ta bëjë nëna e paarsimuar?

A mund të pritët edukimi dhe arsimimi i

nevojshëm i njeriut të ardhshëm, pa prindër, e sidomos pa nënë të arsimuar? Sigurisht që jo. Prandaj nuk është thënë më kot: "Me arsimimin dhe edukimin e fëmijëve duhet filluar 20 vjet para lindjes së fëmijës". Muhammedi paqja e Zotit qoftë mbi të, kishte kërkuar nga zonja Shifa që gruas së tij Hafsës t'ia mësonte shkrim-leximin dhe t'i jepte nga përvoja e saj. Në ndarjen e detyrave nga krijuesi, për shkak të veçorive fizike dhe të cilësive shpirtërore, femrës, për dallim nga mashkulli, i janë dhënë katër privilegje të mëdha: Të jetë shtatzënë, të lindë, t'i japë gji fëmijës dhe të edukojë.

Që ajo të mund t'i kryejë me sukses këto detyra bazë, ajo nuk duhet të konsumohet nga punët e rënda e të lodhshme, që për nga natyra u takojnë burrave t'i kryejnë ato. Prandaj, një grua e punësuar a ka mundësi t'i kryejë gjithë këto detyra? Sipas botëkuptimit islam, preferohet që një femër e aftë për t'i kryer këto detyra primare të saj, të mos i neglizhojë këto për hir të punësimit apo të përfitimit tjetër material, sepse më vonë do të mund të ndeshet me pasoja të llojllojshme negative që do të lindnin si rezultat i mospërfilljes së këtyre detyrave nga ana e saj. Me këtë rast duhet përkujtuar se rolin dhe rëndësinë e institucionit të natyreshëm të familjes nuk e zëvendëson dot asnjë institucion tjetër artificial, siç është çerdhja për fëmijë, bebisiteri etj. Nga ana tjetër, Islami nuk është kundër punësimit të një femre që ka nevojë për të, nëse nuk ka kush tjetër që do t'ia siguronte jetesën, apo një femre tjetër e cila ose ka mbaruar me rritjen dhe edukimin e fëmijëve ose nuk ka mundësinë për të lindur. Pra, marrë në përgjithësi, Islami nuk është kundër punësimit të femrës në punët që ajo mund t'i kryejë, nëse me këtë rast nuk i lë mënjanë detyrat parësore të saj. Kurani thekson luftën e madhe të nënës që ajo bën për fëmijën e saj, për të theksuar nevojën për reciprocitet të fëmijëve në lidhje me sakrificën që ajo ka bërë për ta. Zoti xh.sh. thotë: *"Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërit të vet, sepse nëna e vet atë e barti mund pas mundi dhe pas dy viteve ia ndau gjinin. (e porositëm) Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, sepse vetëm tek Unë është kthimi juaj"* [Lukman, 14]. I njohuri Shejh Abdurrahman Es-Sa'di (vd. 1956) thotë në lidhje me këtë ajet: "...e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërit të vet ka kuptimin, silluni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve tuaj, shfaquni atyre dashuri, ngrohtësi

dhe mëshirë, si me fjalë dhe vepra, trajtoi ata me përlulësi, jepu siguri dhe mos i bëni atyre kurrë dëm, as gojarisht dhe as fizikisht. Pastaj, Zoti përmend arsyen pse ne duhet të jemi bamirës ndaj prindërve tanë, kur Zoti thotë *"sepse nëna e vet atë e barti mund pas mundi"*, d.m.th. nëna pati vuajtje konstante, dhimbje dhe vështirësi nga moment i parë kur ajo ndjeu në bark lëvizjen e fëmijës së saj, duke kaluar më pas në dhimbje të forta gjatë kohës së lindjes. Dhe *"dhe pas dy viteve ia ndau gjinin"* d.m.th. gjatë këtyre dy viteve nëna e ushqen fëmijën e saj dhe kujdeset për të. Pra, pas të gjithë këtyre viteve të vuajtjeve, vështirësive, dashurie dhe kujdesi, nuk mundemi, të paktën, t'ia kompesojmë nënave tona atë që ato kanë bërë për ne dhe t'u japim të drejtat e tyre?

Kur'ani i përsërit vështirësitë e nënës në një ajet tjetër: *"Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet e barti me mundim dhe e lindi me vështirësi. Bartja e tij dhe gjidhënia e tij zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa të arrijë pjekurinë e vet dhe kur t'i mbush dyzet vite thotë: "Zoti im! Më inspiro mua që të falënderoj për të mirën tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mij, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m'i bën të mirë pasardhësit e mi. Unë pendohem te Ti dhe jam me muslimanët"* [Ahkaf, 15]. Edhe pse pjesën e parë të këtij vargu urdhri është të bëjnë vepra të mira për të dy prindërit, fjalja e dytë i referohet vetëm vështirësive të vuajtura nga nëna, sepse ato janë të pashmangshme dhe fëmija nuk mund të lindë pa to. Çdo nënë ka për të hasur probleme gjatë shtatzënisë dhe dhimbje të rënda gjatë lindjes. Për kundër kësaj, nuk është e nevojshme për një baba që ai të vuajë nga ndonjë vështirësi në sjelljen dhe deri në edukimin e fëmijës, nëse ai mund ta përballojë që të paguajë dikë tjetër për këto shërbime. Kjo është arsyeja pse Profeti i ka dhënë më shumë të drejta nënës se kushdo tjetër."

Profeti Muhamed i ka kujtuar shpesh pasuesit e tij për statusin e nënës dhe detyrimin e të qenit i mirë ndaj prindërve. Transmetimi i mëposhtëm është një shembull i bukur i pozitës fisnike të nënës: *"Një njeri erdhi te Profeti dhe tha: "O i Dërguari i Zotit! Kush nga mes i njerëzve e meriton më tepër shoqërinë time, rrespektin tim?" Ai u përgjigj: "Nëna jote." - e pyeti sërish: "E kush tjetër?" Profeti u përgjigj: "Nëna jote." - e pyeti sërish: "Pastaj kush?" Profeti iu përgjigj*

përsëri: *"Nëna jote." E me pas kush e pyeti përsëri?" Ai u përgjigj: "Pastaj babai yt"*

Shejh Abdulaziz Ibn Baz - në komentet e tij për këtë thënie profetike ka thënë: Kjo tregon se nënës i është dhënë tri herë më i mirë dhe trajtim të mirë sesa babait. Ai gjithashtu shkruan: "Sekreti i rëndësishëm së saj qëndron në përgjegjësinë dhe barrën e madhe me të cilën ajo është ngarkuar, si dhe vështirësitë që ajo ka në vetvete - përgjegjësitë dhe vështirësitë disa prej të cilave as edhe një njeri nuk i mbart. Kjo është arsyeja pse nga detyrimet më të rëndësishme mbi një person është të tregojë mirënjohje për nënën, mirësi dhe marrëdhënie të mira me të. Dhe në këtë çështje, asaj duhet t'i jepet përparësi edhe mbi babain. (Mexhmu el Feta'a) Shejh Ibrahim Ibn Salih el-Mahmud shkruan: *"...Bindju prindërve tuaj dhe as mos i zemëro, përndryshe ju do të jetoni një jetë të mjerë në këtë botë dhe botën tjetër dhe fëmijët tuaj do t'ju trajtojnë në të njëjtën mënyrë. Pyetini prindërit tuaj në mënyrën më të butë, nëse kenë nevojë për diçka. Gjithmonë falënderojini ata, nëse ata të japin diçka dhe justifikojini ata nëse nuk ta japin atë gjë që kërkonit prej tyre dhe mos këmbëngulni në qoftë se ata refuzojnë t'ju japin diçka."*

Profeti ka thënë se mirësia ndaj prindërve është një nga veprat më të mira, ai gjithashtu ka thënë se mosbindja ndaj tyre është në mesin e mëkateve të mëdha: *"Mëkatet më të mëdha janë: t'i bësh shok Zotit në adhurim, mosbindja ndaj prindërve, vrasja e një shpirti (njeriu), që e ka ndaluar Zoti dhe dëshmia e rreme."* [Sahih Buhari] Kaq shumë e vë theksin Islami tek prindërit, saqë për muslimanët konsiderohet si një mundësi e madhe për të fituar parajsën në shërbim të nënës. Ijas ibn Muaviju ishte një dijetar i famshëm i islamit nga brezi i dytë i muslimanëve. Kur nëna e tij vdiq, Ijas ibn Muaviju qau. E pyetën: "Pse qan?" Ai tha: "Unë kam pasur dy porta të hapura për në Xhenet, tani njëra prej tyre është e mbyllur."

Dita e nënave është shpikje e atyre që i harrojnë nënat e veta, sidoqoftë mjafton një ditë që t'i kujtojnë të mjerat...Civilizimi materialist ua ka vulosur shpirtat e tyre, pastaj ka pëlçitur dhe ka shkatërruar çdo gjë para tij. Dhurata më e mirë që fëmija mund t'i japë nënës





Kur e lexon këtë titull, mendon me vete se për çfarë vitesh apo shekujsh bëhet fjalë.

Është e çuditshme, por nuk kemi si ti quajme ndryshe.

Janë gratë, gjinia e brishtë, e lodhur dhe e dërmuar nga jeta e jo pak nga dhuna maskiliste.

Janë ata gra që ju mungon liria që

kam unë, liria juaj që ecni dhe dilni të qeta bulevardëve me femijët apo bashkëshortët tuaj.

Janë gratë ne burgjet e Tiranës të cilat vuajnë dënimin e marrë për atë çfarë kanë kryer në momentet e tyre pak a shumë larg botës së saj femërore.

Por e rëndësishme është se ata tashmë jetojnë aty, pa liri, larg

çdokujt, e afër shumë afër dhimbjes së krimit të kryer.

Larg familjes, fëmijëve, kujtimeve të bukura. Aty janë bashkë, një kontigjent grash, që i lidh gjinia e tyre, por i ndajnë, ëndërrat dhe dëshirat që kanë, premtimet që lanë përtej kangjellave, e pendimit që shtrëngojnë thellë në gji.

Nga: A. Muja

Ata janë atje. Jemi mësuar t'i njohim si të dënuara, dhe si pjesë e akullt burgu, vetëm burrat, botën që shpesh ia mveshim vetëm atyre dhunën, por jo. Ja ka edhe gra, vajza, madje të moshuara.

Përtej kushteve të përmirësuar të burgjeve, aty ka akoma klithma.

Ka akoma tym e errësirë, frike, dhimbje e harresë.

Ata janë aty ku i thërret vetëm vetmia dhe frika se nuk do munden të ndryshojnë për më mirë.

Secila e ngjashme, e secila ndryshe nga tjetra, me probleme e peripeci.

Gdhihen e ngrysen duke qënë të dënuara në fatin e tyre, e në gabimet e tyre.

Gdhihen duke shpresuar të jenë të falura jo vetëm nga trupi gjykues, por edhe nga familjarët e tyre, edhe nga Ai që e ka ndaluar vrasjen, por edhe dhunën ndaj tyre, ndaj Zotit të Lartë, e ngrysen duke menduar se nuk do të paragjykohej.

Por sërish, shoqëria në ecje galopante nuk i lë pas diskriminimet, dallimet, e marginalizimin në çdo skaj. Ato sërish ndjehen si fajtores e gra që duhet pasur frike nga to- thotë një gardiane, sepse kështu kemi dëgjuar dhe kështu është realiteti.

Ato, nuk duhet harruar! Ato janë nëna, gra. Gratë kudo në botë janë të brishta e thyhen lehtë, të përvuajtshme e hallet mëdha. Shoqëria dhe shteti duhet të bëjë

diçka. Me mjaft ndryshime e reforma, me politika pro rolit dhe pozites së saj në shoqëri, janë bërë reforma në mbrojtje të të drejtave të saj, por sërish, krimi vret, ai ther gjer në kockë, dhe familja po përjeton kriza të kobshme.

Është ekonomia e, niveli i ulët i saj, varfëria, papunësia, që i shtojnë hallet një çifti i cili mes shumë zenkash e mospajtimesh me realitetin jetik, e barkun e pabukë të fëmijëve, me zhgënjime nga më të shumtat, zihen e grinden, fajësojnë njëri-tjetrin e luftojnë pa ditur se nuk janë armiq, e kjo luftë patjetër që përfudon me krime, me të plagosur e viktime.

Ja, krimi, për gratë e këtyre burgjeve, e ja viktimat e tyre, ata që tashmë s'janë më nga dora e krimit të tyre, e viktime që gjallojnë, janë fëmijët e tyre të pafaj.

Një dorë që tund djepin, nuk mund të ngrihet kurrë drejt vrasjes a krimit, por ja që ndodh.

Momentet e pafuqishme të lodhjes, momentet fatale me mungesë të fortë durimi e besimi, çojnë në humnerë, në humbje shkatërrim të familjeve e më pas vetmi, dhimbje, lot e pendesë, ku çdo gjë ka shkuar tashmë aty ku nuk kthehet, e ti detyrohej të jesh e vetmja tek rrit fëmijet e "pa baba", apo t'i që rritesh duke qënë vrasëse e prindërve të tu, vëllait apo motrës.

Rrethanat janë nga më të ndryshmet aq sa shpeshherë të justifikojnë, por ti duhet të gjesh forcën e madhe të shpirtit femëror, atë larg

krimit dhe gjakut, zisë e trishtimit.


Tidenoncoje dhunën ndaj teje, si nga vëllai, babai apo dhe motra, kunati, punëdhënësi a çdokush tjetër, dhe ji ajo që parandalon sëmundjet që të kanosen e jo ajo që merr përsipër shërimin e plagëve që s'mbyllen dot.

Ndaj në këtë muaj ku të gjithë, sidomos tek ne në Shqipëri festojnë, se është një ditë që "kujtohet nëna" apo gruaja", mos u ndiej e trishtuar. Tisi i zi i atij burgu të errët, të ndihmojë të qartësojë mendje e arsyen e të pendohesh, me veten tënde, por më së shumti para Krijuesit tënd.

Si e lexon ti fjalën e Zotit kur thotë; "Kush vret një njeri është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin" e të tjera thënie të tjera profetike, ku urdhërohet në maksimumet e saj dashuria për prinderit e fëmijët, për të afërm e farë e fis etj ?

Sot ndoshta shumica dërrmuese po gëzojnë, po festojnë, por kjo datë të mos te gjejë melankolike. Nuk është një datë feste, por proteste që daton shumë kohë para kësaj që po jetojmë ne, kur gratë në mbarë botën protestonin për të drejtat e tyre, për të drejte respekti, pune, vote, fjale etj.

E ti këtë ditë merre si të tillë; të protestosh me veten, e të gjesh brenda vetes pika që kur i bashkon bashkë, nxjerrin në pah një grua të fortë, e të penduar.





IMAZH

Jetesa e tyre ndryshe, e aq më tepër veshja e tyre, duket sikur i bën të ndryshme, të gatshme për tu paragjykuar, për t'u marginalizuar e stigmatizuar si ajo pjesë e shoqërisë, e cila ka pengesa të shumta për t'u integruar në shoqërinë që ecën pa ndalur.

Por, nuk është ashtu!

Nuk është hera e parë, por kjo është dukur më e veçantë, kur vajzat dhe gratë të këtij besimi, ish studente të shkëlqyera, në degë nga më të veçantat e larmishmet, si shkenca politike, apo sociale, arte të bukura, letërsi, drejtësi etj, me datën 20 shkurt 2010 u promovuan në aktivitetin me logon: "Mesazhi im... Përtej fjalës"

Ishin piktores, skulptore, poete, shkrimtare të reja, gazetarë dhe reportere, secila me të veçantat që i kish sjellë botës së artit, kulturës e medias me aq sa kishte pasur "hapësirë".

Ky aktivitet u ndërthur këndshëm, duke paraqitur në pjesën e parë të tij analiza dhe mendime, opinione mbi librat me poezi dhe me ese të tre poeteshave të reja si: Jerida Kulla, Anisa Proda, Mercedes Gega, vlerësuar këto nga Znj. Elsa Xhai, e Shega Murati.

Ndërkohë më pas ishte rradha e vlerësimit nga një pedagoge pranë Arteve pamore, vlerësim i pikturave dhe skulpturave përkatësisht

të autoreve, Monda Maksutaj, Majlinda Shala, Albana Xhallamati e Denisa Paho.

Ishin vlerësime, opinione, fjalë mirësie që mbushën sallat e mbresa ku pedagogia e tyre sillte ndër mend vajzat besimtare me të cilat kish punuar dhe tani po i vlerësonte sërish. Minutë pas minute, logoja "mesazhi im,... përtej fjalës, ftonte për tek pjesa e dytë e tij.

Çfarë ishte: "Përtej fjalës"

Është titulli i kësaj reviste të dalë në tregun mediatik tashmë prej 7 muajsh.

Një revistë kulturore me një vision e mison të qartë.

Ashtu siç edhe titulli e tregon. Te ikurit, përtej fjalës, është ajo që na zgjon për të sjellë diçka ndryshe, diçka përtej fjalëve që hidhen në tregun mediatik aq kontravers e pervers gati-gati pa një të vërtetë.

Përtej fjalës kërkon të prekë fuqinë e veprës, e aksionit, e asaj çfarë fshihet pas fjalëve që shpeshherë i merr era-mjaft më me fjalë, të cilat nuk i ndjek as vepra e as dinjiteti - shprehet kryeredaktorja e kësaj reviste.

Ky takim, siç edhe mund të kuptohet nga gjysëm titulli, kishte në fokus edhe promovimin e kësaj reviste, ndaj edhe me këtë rast mbajti fjalën e saj, pedagogia Prof. dr. Mimoza Gjokutaj, ne pozicionin e redaktorese gjuhësore pranë: "Përtej fjalës".

Ata që vlerësuan ishin vërtet që ishin mësuar me notat dhe rezultatet, me arritjet dhe mosarritjet, por kur në fund çdo gjë u kurorëzua me më "të mirën" mbetet

për të thënë: ishte një takim mes artistësh të rinj e pa shumë përvopë, por që fjala e profesorëve të tyre foli për shpresa të mëdha që ky brez artistësh do të dijë të ecë përpara edhe pse nën vëzhgime të çuditshme, të pamjes së tyre të jashtme.

Ky aktivitet nuk kishte si të mbyllej veçse me: "fjalë"

Ndaj edhe pas analizës së librave, pikturave, ishte vetë ekspozita me piktura e skulptura, me punime artizanale, një ambient konkret tashmë që shikohej e prekej, vlerësohej e çmohej.

Një art i mbajtur në sirtare autoresh të reja, që kërkonte medoemos të njihet, të dilte përtej "sirtareve", përtej errësirave të mosnjohjes, e tingujve të heshtur.

Dhe kjo u bë realitet nga vizioni prej gruaje të ndjeshme, e të aftë për organizime të tilla, ku qëllimi saj ashtu siç edhe pozicioni që mban është i tillë; përkrahja në çdo hap e grave, e vajzave, Iris Maci, Kryetare e Departamentit të Gruas pranë KMSH në bashkëpunim me shoqatën Kulturore FIF; "Femra investim i familjes me qendër në Tiranë me experiencë shumëvjeçare në fushën e promovimit, ndihmës dhe përkrahjes së femrës besimtare shqiptare.

Duke shpresuar se aktivitete të tjera të vërshtojnë në çdo suazë të jetës së kësaj shoqërie në ngritje, urojmë që ky aktivitet të ketë qenë një fillësë e mbarë për të njohur botën që na rrethon se "vërtet mesazhi i këtyre vajzave përcjell vlera.



Nga: Oriola Heta (Varosi), Sociologe

AUTIZMI

sfida e shekullit të ri

Unë mund të kem një rrugë shumë të gjatë për të bërë,
por nuk kam frikë t'i hedh hapat një e nga një

Çfarë është Autizmi? Autizmi është një çrregullim i rëndë i funksioneve të trurit dhe për rrjedhojë i sjelljes njerëzore, që sjell probleme të komunikimit, ndërveprimit dhe përfytyrimit shoqëror. Njerëzit që vuajnë nga autizmi shpesh kanë një rreze të kufizuar interesash dhe shfaqin sjellje dhe mënyra të sjelljes përsëritëse, si dhe kundërprime të ndryshme me mjedisin dhe rrethanat e përditshme. Në përgjithësi aftësitë e tyre për të zhvilluar shoqëri dhe aftësia e tyre për të kuptuar shprehjet emocionale të njerëzve të tjerë janë të kufizuara. Kjo sëmundje është identifikuar në vitin 1943, por edhe sot ajo rezervon shumë të panjohura për njerëzimin. Sipas mjekëve specialistë autizmi është një sëmundje e cila shfaqet tek fëmijët para se ata të arrijnë moshën 3 vjeçare dhe shoqërohet me vonesa në ndërveprimet e tyre shoqërore, gjuhë, shenja apo lojëra përfytyruese. Vitet e fundit numri i fëmijëve autikë është rritur ndjeshëm, studimet tregojnë se djemtë janë më të prekur se vajzat.

Cila janë shenjat që duhet t'i bëjnë prindërit të shqetësohen për fëmijët e tyre?

Shenjat e hershme të sindromës së autizmit mund të kuptohen nga një specialist kur fëmija është në muajin e pestë, ndër-sa shenjat me të dukshme variojnë nga 18 deri në 36 muajsh. Karakteristike e kësaj sindrome është se fëmija mund të zhvillohet pa shfaqur shenja shumë të dukshme të çrregullimit deri në moshën 16-18 muajsh dhe pas kësaj moshe, nëna mund të identifikojë probleme në zhvillimin e tij. Fëmijët autikë kanë probleme të komunikimit, mbyllen në vetvete, nuk krijojnë lidhje emocionale, nuk shoqërohen me mosha-tarët, fiksohen pas një sendi apo objekti, në shumicën e rasteve janë hiperaktivë, por nuk përjashtohen rastet hipoaktivë. Çrregullimet e gjuhës dhe komunikimit, simptomat më karakteristike të fëmijët autikë, evidencohen kur fëmija nis të flasë, prandaj dhe prania e tyre përbën një nga kriteret diagnostikuese. E folura herë mungon, herë është e vonuar ose dhe atipike. Fëmija nuk të shpreh ne sy kur i flet apo bën lëvizje drejt tij. Është indiferent ndaj të tjerëve, lojërave, qoftë edhe ndaj prindërve. Ka tendencë të rijë i tërhequr, nuk reagon nga përkëdheljet. Përplas koken në objekt të fortë, apo shfaq tendencë autolezionimi. Bën veprime të përsëritura dhe obsesive. Përsërit fjalët që i thuhet, pa qenë

në gjendje të thotë fjalë tjera apo përgjigje).

Ulëret kur e largon nga një vend që atij i duket i rehatshëm, por nuk të sheh në sy.

Nuk flet apo flet shumë pak

Nuk të rikthen buzëqeshjen.

Nuk përgjigjet kur e thërret me emër.

Autizmi është një sëmundje, e cila pranohet me shumë vështirësi nga prindërit, por duhet të theksojmë se sa më shpejt të identifikohet dhe të trajtohet ajo, aq më e lehtë do të jetë si për fëmijën edhe për prindërit.

Llojet e autizmit

Eksistojnë dy lloje të autizmit, sindroma e Apsbergut dhe sindroma e Kanerit. Sindroma e Apsbergut është një formë më të lehtë e autizmit, ku edhe shanset e shërimit janë më të mëdha. Ndërsa sindroma e Kanerit është forma më e rëndë e autizmit dhe ku mundësia e shërimit është minimale.

Trajtimi

Autizmi mendohet si një sëmundje e pashërueshme, megjithëse ky mendim është i diskutueshëm. Ka shumë terapi autiste me synime të ndryshme, p. sh. të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies, problemeve emocionale, shqisore, vështirësive me mësimin dhe komunikimin etj. Sa i përket trajtimit të autizmit, ka shumë terapi që aplikohen duke u nisur prej metodave edukative dhe duke përfunduar me medikamente. Janë prindërit ata të cilët luajnë një rol të madh për t'i ndihmuar fëmijët

me autizëm që ata të mos veçohen nga shokët e tjerë dhe madje të zhvillojnë talentet e tyre. Është e vështirë të pranosh që fëmija yt nuk është dhe nuk do të jetë kurrë si të gjithë fëmijët e tjerë, por edhe në këtë rast prindërit mund të bëjnë gjithçka. Zbuloni cilat janë talentet dhe dëshirat e tyre dhe ndihmohini të realizojnë dëshirat e tyre dhe gjërat do të ndryshojnë pozitivisht. Një shembull i vërtetë i kësaj që po themi është edhe rasti i 6 vjeçarit Klodi. Si shumë fëmijë të tjerë, vogëlushit i pëlqen të luajë në parqe. Por ndryshe nga fëmijët e tjerë, ai ka nevojë për ndihmën e nënës që të lëvizë nëpër park, sepse është pjesërisht i verbër dhe vuan nga autizmi. Por ai ka diçka shumë të veçantë.

Në një festival muzikor të qytetit, Klodi këndon këngën e hapjes. Kënga është bërë tashmë pjesë e pandarë dhe e rëndësishme e këtij vogëlushi.

Që kur ishte një vjeç, thonë prindërit e tij, ai mësoi të mbante ritmin me duar dhe me këmbë. Ata i blenë një piano elektronike dhe ai filloi të përsëriste këngë pas kënge megjithëse i kishte dëgjuar vetëm një herë.

Kështu një grup muzikor vuri re se si Klodi mbante ritmin dhe e ftoi atë në skenë.

Ai këndoi atje këtë këngë dhe papritur u gjallërua si kurrë më parë.

Njerëzit filluan të brohorasin dhe ai e ndjeu veten të lumtur, thotë nëna e Klodit.

Kjo na gëzoi sepse ne e kuptuam se muzika do të ishte shpëtimi i tij, thotë i ati.

Si gjithë fëmijët me autizëm, Klodi e ka të vështirë komunikimin, por me anë të muzikës ai ka krijuar gjuhën e tij të veçantë. Prindërit e tij tani kanë kuptuar diçka tjetër, thotë një ekspert. Kjo lloj gjuhe e ka ndihmuar atë për gjithçka, të mësojë dhe të zerë shokë. Muzika e ndihmon atë të qetësohet shpirtërisht dhe të përqaëndrohet. Ndërsa prindërit po bëjnë gjithçka që ai ta zhvillojë një pasion të tillë.

Kur e shikon se sa i qetë dhe i lumtur është, për prindin nuk ka ëndërr më të bukur, thotë i ati i këtij fëmije të talentuar.

Njesoj si Klodi mund të jetë edhe fëmija juaj, të ndjehet i realizuar dhe i lumtur, falë përkushtimit dhe punës suaj.

Falenderimi i takon Zotit, Zotit të botërave, Krijuesit të Gjithesise, Furnizuesit dhe Meshiruesit, Ai që krijoi burrin dhe gruan që të gjejnë qetësi tek njëri-tjetri.

Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të dërguarin e Tij Muhamedin, familjen e tij, shokët e tij dhe pasuesit e tij deri në ditën e Fundit.

Një nga rrugët më të efektshme që të rrisin besimin në zemër është të nxjerrësh në dritë jetën e disa besimtareve të para në historinë e njerëzimit.

Më poshtë po flasim në mënyrë të përmbledhur për jetën e gruas së parë të njerëzimit Havasë bashkshortja e Ademit.

Merjemen e devotshme, nënën e Isait

Dhe bashkshorten e të Dërguarit tonë Muhammed, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, Hadixhes Tahra (e pastër)

Kush janë gratë më të mira të universit?

nga: Aida Kurti

Hava

Merjeme

Hadixhe

Jeta e Havase



ju njerëz, kini frikë Zotin tuaj, që ju krijoi prej një veteje dhe nga ajo krijoi palën e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra dhe gra dhe kini frikë Zotin, që në emrin e Tij përбетoheni". (En-Nisa 1)

Havaja (Eva), është nëna e gjithë njerëzimit. U quajt Hava, sepse u krijua nga diçka e gjallë, nga Ademi a. s.

Ademi a. s u krijua nga dheu i tokës, ndërsa Havaja u krijua nga brinja e tij.

Secili u krijua nga elementi me të cilin do të merrej gjatë jetës.

Kështu që, Ademi do merrej me tokën, punimin e saj etj, ndërsa Havaja do të merrej me edukimin e fëmijëve.

Profeti, bekimi i Zotit qoftë mbi të thotë: "U këshilloj të silleni mirë me gratë pasi gruaja është krijuar nga brinja dhe pjesa më e shtrembër e brinjës është fundi i saj. Nëse do të përpiqesh ta drejtosh do e thyesh e nëse do e lësh ashtu siç është do të mbetet e shtrembër. Prandaj silluni mire me gratë."

Kjo thënie profetike nuk na tregon se gruaja është e shtrembër në natyrë, por u tregon burrave se si duhet të sillen me gratë e tyre dhe se brinja është një simbol, që përfaqëson detyrat e burrit ndaj gruas si dhe varësinë e gruas ndaj burrit për kujdes dhe mbrojtje.

Zoti i Lartëmadhëruar urdhëroi Ademin të jetonte në parajsë së bashku me gruan e tij Havanë dhe aty të shijonin begatitë e shumta të parajsës, përveç një peme. Pra ishte në dëshirën e Zotit që të ishin të limituar si në aftësi ashtu dhe në zgjedhje.

Kjo shpjegohet kështu në Kuranin Famëlartë: "E Ne i thamë: O Adem banoni, ti dhe bashkëshortja juaj në xhennet (parajsë) dhe hani lirisht nga frutat e tij çfarë të doni, por mos iu afroni asaj peme e të bëheni zullumqarë" **el-Bekare 35**

Por shejtani i mallkuar i cili ka për qëllim mashtrimin e atyre që besojnë, bëri punën e vet duke iu përmbajtur asaj që i kishte kërkuar Zotit në momentin e mallkimit. "Dhe do i gësh shumicën e tyre mosmirënjohës" **el-Araf 17**

Për mashtrimin e Ademit dhe Havasë ai ndërmoi disa hapa.

Hapi i parë ishte emërtimi i pemës me emrin pema e përjetësisë.

"Zoti juaj nuk ua ndaloi ju të dyve atë pemë, vetëm që të mos bëheni melekë ose mos të bëheni prej të përjetshmëve" **(el-Araf 20)**

"O Adem a të tregoj mbi pemën e përjetësisë dhe pushtetit të përjetshëm" **(Taha 120)**

Hapi i dytë që ndërmoi ishte betimi i rremë në Zotin, e duke qënë zemrat e tyre të pastra me të dëgjuar betimin në Zot i besuan fjalëve të tij. "E me mashtrim ai rrëshqiti drejt gjynahut" **(el-Bekare 36)**

Zoti u drejtoi atyre të dyve këtë pyetje retorike: "A nuk ua ndalova ju të dyve atë pemë dhe a nuk ju thashë ju se shejtani është armik i haptë për ju." **(el-Araf 22)**

Në suren el-Araf shpjegohet qartë se të dy ishin përgjegjës për atë që ndodhi dhe se te dy u mashtruan nga shejtani i mallkuar, të dy kerkuan falje nga Zoti e Ai i fali.

"Ata thanë: O Zot ne i bëmë padrejtësi vetes tonë dhe nëse nuk na fal do të jemi prej të humburve" **(el-Araf 23)**

Zoti me mëshirën e Tij të pafundme e pranoi pendimin e tyre dhe i zbriti në tokë. Aty i urdhëroi ta popullonin tokën me pasardhës. Nga çdo shtatzani u lindnin dy binjakë. Të dy se bashku jetuan një jetë të begatë dhe shejtani nuk arriti kurrë më, që ti mashtronte.

Pas vdekjes së Ademit, Havaja u mërzi dhe u pikëllua aq shumë sa që qau për një vit derisa vdiq edhe ajo. Kjo dashuri dhe respekt që kishin mes njëri-tjetrit është vërtetimi i thënies së Havasë Ademit a. s: Jam krijuar për të gjetur prehje tek unë.

Jeta e Merjemes

Ne Kur'anin Fisnik përmendet një sure e plotë me emrin e një familjeje, qe quhet Ali-Imran. Kjo familje ishte një familje profetësh dhe njerëzish të mirë e të njohur për besim e devotshmëri në mesin e popullit izraelit. Imrani dhe gruaja e tij nuk kishin femije, ngase gruaja e Imranit nuk mund të lindte më fëmijë, për shkak të moshës së thyer që kishte.

Kjo grua fisnike nuk u dëshpërua asnjëherë, por i lutej Zotit përherë që t'i dhuronte asaj një djalë, që t'i shërbente tempullit të shenjtë në Palestinë.

Dhe në të vërtetë Zoti iu përgjigj lutjes së saj dhe të burrit të saj.

E gjithë kjo përmendet kështu në Kuran:“(Përkujto) Kur gruaja e Imranit pati thënë:Zoti im, unë këtë që kam në bark vendosa t'ia kushtoj çështjes tënde, prandaj pranoje këtë prej meje. Vërtet Ti Je Ai që dëgjon dhe di”. Ali Imran35

Dita e lindjes po afronte dhe Zoti me urtësinë e Tij në vend të djalit dhuroi një vajzë. Ashtu e mërzitur dhe me zemër të thyer gruaja e Imranit tha: “Zoti im unë e linda femër. Zoti e di më mirë atë që lindi. E mashkulli nuk është si femra. Dhe une e quajta atë Merjeme. Atë dhe pasardhësit e saj po ti lë Ty në mbrojtje prej djallit të mallkuar”. Ali Imran 36

Pra,vajza e lindur u quajt Merjem. Nëna i vdiq disa muaj pas lindjes së saj.

Duke përmbushur zotimin e bërë nga nëna e Merjemes,ajo jetoi në tempullin e shenjtë ku adhuronte Zotin me përkushtim dhe devotshmëri. Dhe ishte pikërisht ky vend i shenjtë ku engjëjt i flisnin Merjemes duke i thënë:“O Merjem, me të vërtetë që Zoti të zgjodhi ty, të pastroi e lartësoi mbi gratë e botës”. Ali-Imran 42

Zoti e nderoi Merjemen mbi gratë e botës për dy cilësitë e saj, e para, ishte adhurimi dhe përkushtimi, ndërsa e dyta, nderi dhe morali i lartë.

Ai që e mori në përkujdesje Merjemen pas vdekjes së nënës së saj ishte Zekerija, i cili ishte profet si dhe burri i tezes së saj.

Gjatë qëndrimit në tempullin e shenjtë, Merjemes i zbritnin ushqime e begati të shumta, derisa edhe Zekerija u habiste nga

kjo dhe iu drejtua me këto fjalë: “O Merjem, nga të vjen ky ushqim? Ajo i thoshte: Ai është nga Zoti. Zoti e furnizon atë që do pa masë”. Ali Imran 37

Një ditë,ndërkohë që ajo po adhuronte Zotin në tempullin e shenjtë, engjëlli Xhibrili iu paraqit asaj në formën e një burri.

Ajo u frikësua shumë dhe u dridh, por ai e njoftoi se ishte i dërguar nga Zoti për ta përgëzuar atë me lindjen e një fëmije (djali).

E çuditur tha: “Si do të kem unë një djalë, kur mua nuk më është afruar njeri, dhe as nuk kam qënë e pamoralshme”. Merjem 20

Atëherë, Merjemi ndjeu fëmijën të lëvizë në barkun e saj dhe ndërkohë e pikëlluar thoshte: “Ah,sikur të kisha vdekur para kësaj dhe të isha harruar” Merjem 23

Ajo vendosi që të largohej jashtë qytetit, sepse e dinte që njerëzit e saj do ta akuzonin për fëmijën e lindur kur ajo ende nuk ishte martuar.

Në prag të lindjes Merjemi u ul pranë një trungu të një palme të thatë,i cili u bë një burim uji i freskët duke i lëshuar Merjemes hurma të freskëta sapo ta prekte.

Pas lindjes ajo u urdhërua nga Zoti që mos i fliste njeriu.

Kështu që, vendosi të kthehej në shtëpinë e saj bashkë me foshnjën e lindur duke zbatuar urdhërin e Zotit që mos t'i fliste askujt.

Kur arriti tek të afërmit e saj, e pyetën se cili ishte ai fëmijë që e mbante në krahë?

Ajo drejtoi gishtin drejt tij,që ta pyesnin atë e t'u përgjigjej për çdo gjë.

Ata e konsideruan këtë gjë si tallje e çmenduri dhe filluan ta qortonin atë. Mirëpo mrekullia e Zotit u shfaq në komunikimin e Isait foshnjë. Ai filloi të fliste duke shfaqësuar nënën e tij nga akuzat e shumta që i kishin thënë.

Ky komunikim ishte i mjaftueshëm për tu treguar njerëzve të vërtetën rreth lindjes së tij, ku Ai që bëri të flasë një foshnjë, ka fuqi që ta krijojë atë në barkun e nënës së tij pa u martuar.

Merjemi jetoi me të birin derisa u rrit dhe filloi t'i thërrasë njerëzit në besimin dhe adhurimin e Një Zotit të Vetëm.

Ajo femër fisnike u bë shembull nga Zoti për të gjithë ata që besuan në suren Et-Tehrijm 11-12. “ E atyre që besuan, All-llahun u solli

shëmbull gruan e faraonit kur ajo tha: “Zoti im, më bëj një vend pranë mëshirës sate në Xhennet dhe më shpëto prej faraonit e brutalitetit të tij dhe më shpëto prej popullit mizor!Edhe Merjemen të bijën e Imranit, që e ruajti nderin e vet, e Ne prej anës sonë i frymëzuam një shpirt e ajo i besoi fjalët e Zotit të saj dhe librat e Tij dhe ishte e devotshme.”

Thesar

Jeta e Hatixhes



jo lindi në Mekë në vitin 556. Ajo rrjell nga një familje fisnike. Nënë e saj e quanin Fatime bint Zejd dhe babain Hauejlid bin Asad. Ai ishte një prijës shumë i përmendur në fisin e kurejshëve dhe një tregtar shumë i suksesshëm gjithashtu. Burri i Hatixhes (para të Derguarit Muhammed) kishte vdekur duke i lënë asaj një pasuri shumë të madhe. Mprehtësia dhe aftësitë tregtare bëri që biznesi i saj të ishte ndër më të suksesshmit ndër kurejshët.

Muhamedi, paqja e Zotit qoftë mbi të,në atë kohë respektohej nga të gjithë,madje nga besueshmëria e tij,ai mori nofken “el-emijn” që ka kuptimin i “besueshëm”. Hadixhja duke dëgjuar për ndershmërinë dhe sjelljet parimore të profetit Muhammed, i ofroi atij punë,që të drejtonte karvanet tregtare dhe i besoi atij pasurinë e saj. Shërbëtori i saj i hershëm dhe shumë i besueshëm Maisarah u zgjodh për ta shoqëruar dhe për t'i shërbyer. Gjatë udhëtimit Maisarah u habit nga skenat e mrekullueshme që i zunë sytë. Forca e karakterit, besnikëria ndaj parimeve,qëndrimi miqësor dhe aftësitë tregtare të profetit i lanë përshtypje të jashtëzakonshme. Kur u kthye, ai i tregoi Hatixhes çdo gjë që kishte ndodhur. Asaj i bënë shumë përshtypje ato që dëgjoi dhe mori vendimin se Muhamedi do të ishte bashkshorti më i mirë për të, edhe pse fisnikët më të shquar të kurejshëve kishin kërkuar dorën e saj. Muhamedi dhe Hadixhja u martuan,ku në atë kohë profeti ynë ishte 25 vjeç dhe Hadixhja ishte 40 vjeçe. Martesa qe shumë e begatë dhe ata patën gjashtë fëmijë,dy djem Kasimin, prej të cilit profeti njihej dhe

me emrin Ebul-Kasim dhe Abdullahun që njihej dhe si Tahir (i pastër) apo Tajjib (i mirë). Të dy vdiqën në fëmijëri.

Më pas pasuan katër vajzat, Zejneb, Rukija, Umu Kulthumi dhe Fatimja. Të katër vajzat u rritën besimtare të devotshme në Islam. Të gjitha emigruan në Medine me profetin. Tre vajzat e para vdiqën ndërkohë që profeti ishte ende gjallë,ndërsa vajza e tij e dashur Fatimja vdiq vetëm gjashtë muaj pasi ai ndërroi jetë. Ata ishin fëmijë të zgjuar e të mrekullueshëm dhe shtëpinë e karakterizonte një atmosferë e lumtur dhe e paqme.

Kur Xhibrili iu shfaq për herë të parë profeti Muhammed ashtu i frikësuar shkoi tek Hadixhja dhe i rrefeu asaj atë çfare i kishte ndodhur. Ajo duke dëgjuar me vëmendje dhe kujdes fjalët e tij iu drejtua me këto fjalë:“Mos u shqetëso,sepse pasha Atë që ka në dorë shpirtin e Hadixhes shpresoj që ti të jesh i dërguari i këtij kombi. Zoti nuk do të turpërojë. Ti i mban lidhjet farefisnore,ndihmon të varfërit dhe të ngratët,i pret mirë mysafirët dhe i ndihmon fatkeqët”. Këto fjalë ëmbëltuese dhe inkurajuese ishin prej Hatixhes fjalë me

të cilat profeti fitoi forcë, besim dhe qetësi shpirtërore.

Pasi profeti u qetësua pak, ajo shkoi bashkë me të, që të bisedonin me kushërin e saj Uaraka bin Neufel, pasi ai ishte një njeri i ditur i cili kishte studiuar me vëmendje librat e shenjtë. Ai ishte në dijeni të ardhjes së një të dërguari të fundit që ishte parathënë nga profeti Musa dhe Isa. Pas dëgjimit të asaj që i kishte ndodhur profetit Muhammed, Uaraka i tha profetit se ai ishte i Dërguari i fundit dhe shprehu dëshirën për të jetuar në kohën kur do dëbohej nga njerëzit e tij. Pa kaluar shumë kohë profeti Muhammed u urdhërua nga Zoti që t'i ftonte njerëzit që të adhuronin vetëm Zotin. Dhe ishte Hadixhja e para, e cila nuk hezitoi të shprehte haptazi atë që ajo e kish mbajtur të fshehur për pak kohë. "Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Zotit dhe se profeti Muhammed është i Dërguari i Zotit"

A nuk është nder i madh për gratë që i pari person që përqafoi Islamin ishte një grua?

Në vitet e vështira që pasuan, gratë të cilave prijësit e kurejshëve bënë gjithçka që kishin në dorë për të dëbuar profetin Muhammed dhe për ta ndaluar të përhapte mesazhin e tij, Hadixhja që burim i përhershëm i ndihmës, përkrahjes dhe qetësimi për të dërguarin Muhammed paqja e Zotit qoftë mbi të.

Hatixhja ishte një grua dhe nënë ideale. Profeti jetoi me të në shtëpinë të cilën u bë qendra e Islamit që frekuentohej shpesh nga sahabë, gra dhe burra. Hatixhja vdiq në moshën 65-vjeçare duke lënë pas plot 25 vite përkushtimi ndaj Muhamedit dhe Islamit.

Kur Muhammedi e pa në çastet e vdekjes e ngushëlloi duke i thënë se kështu kishte vendosur Zoti për të dhe se ajo për të cilën frikësohej ishte diçka shumë më e mirë. Në ato çaste ajo ngriti sytë dhe vështroi burrin e saj të dashur, e më pas shpirti i saj u shkëput nga trupi tokësor. Varri u përgatit në vendin e quajtur Huxhun, afër Mekës. Muhamedi zbriti vetë për të parë nëse çdo gjë ishte ashtu siç duhej dhe me duart e tij zbriti lehtë e butë trupin e saj në tokë. Kështu u largua nga kjo botë nëna e të gjithë besimtarëve, që sakrifikoje çdo gjë për Islamin.

Dashuria dhe mëshira kishin lëshuar rrënjë të thella mes tyre aq sa edhe vdekja nuk

mundi t'i shuante. Profeti Muahmmmed nuk reshti kurrë së dashuri Hatixhën edhe pse u martua me grua tjetër pas saj. Një herë Profeti Muahammed i tha Aishes këto fjalë për të: "Ajo besoi tek unë kur askush tjetër nuk besoi, ajo pranoi islamin kur njerëzit e tjerë më refuzuan dhe më ndihmoi e me ngushëlloi kur askush nuk qe aty për të më ndihmuar".

Aishja gjithashtu tregon se sa herë që profeti do të fliste për të, do të gjente shprehjet më të larta, do të vinte në pah cilësitë më të mira dhe do të lutej e do të kërkonte falje për të. Të devotshmit do të priten ashtu siç e ka përmendur Zoti në suren Fexhr në Kuranin Fisnik:

"O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu tek Zoti yt i vetkënaqur dhe i kënaqur (me Të)! Hyn në turmën e robërve të Mi dhe hyn në Xhennetin tim." 89:27-30

Hadixhja ishte nëna e Fatimes, gruas më të dalluar në Parajsë, gjyshja e nipërve të dashur të profetit, Hasanit dhe Husejnit (Zoti qoftë i kënaqur me ta), që janë më të dalluarit nga të rinjtë e parajsës. Abdullah ibn Abasi tregon se një ditë profeti hoqi katër viza në tokë dhe i pyeti shokët e tij se çfarë nënkuptonin ato viza. Ata me respekt të madh iu përgjigjën se ai e dinte më mirë. Më pas ai u tregoi se katër vizat paraqisnin gratë më të larta e të nderuara të Universit: Hatixhe bint Hauajlidin, Fatime bint Muhamedin, Merjem bint Imranin, nëna e profetit Isa, dhe Asiye bint Mazahimin (gruaja e Faraonit), Zoti qoftë i kënaqur me të gjitha. Dhe në një hadith tjetër ka thënë: "Më e mira e grave të kohës së saj ishte Merjemja, vajza e Imranit, dhe gruaja më e mira e kohës se saj ishte Hadixhja vajza e Huuejlidit".

Fisnikëria e karakterit të Hatixhes dhe morali i saj i lartë e kënaqën aq shumë Zotin e botëve sa dërgoi engjëllin e Tij, Xhibrilin, për ta përsëndetur. Këtë profeti ia tregoi Ebu Hurejres dhe përmendet në librat e saktë të transmetimeve "Sahihun" e Buhariut. Kur Hadixhja që ende gjallë, erdhi Xhibrili te i dërguari Muhammed dhe tha: "O i dërguari i Zotit, Hadixhja është duke ardhur me një enë ushqim për ty. Kur të vijë tek ti jepi selam nga Zoti i saj dhe nga unë dhe përgëzoje me një shtëpi prej margaritarësh në Xhennet në të cilën nuk ka zhurmë".

VAZHDON ...

unë pyes?

PLANIFIKIMI FAMILJAR

V Ë S H T R I M I J U R I D I K

Në radhë të parë duam të sqarojmë faktin se Islami është kundër marrëdhënieve seksuale jashtë martese, por është për marrëdhëniet vetëm ndërmjet dy bashkëshortëve të lidhur në kurorë. Në këtë temë nuk kemi për qëllim të flasim për planifikimin familjar të çiftëve jo të martuar, por do të flasim për planifikimin familjar në një çift bashkëshortësh.

Shumë gra muslimane kur dëgjojnë termin "planifikim familjar" mendojnë se ajo është një gjë e gabuar dhe e ndaluar në Islam. Ajo çka duhet të bëjnë këto gra është interesimi i tyre në atë se si Islami e sheh këtë fenomen dhe nëse e lejon atë apo jo, sigurisht duke u bazuar në argumentet kuranore dhe ato të traditës profetike. Në këtë temë kemi për qëllim t'u japim përgjigje këtyre pyetjeve:

Çfarë është planifikimi familjar?

Cilat janë llojet dhe metodat e planifikimit familjar dhe cilat prej tyre janë të lejuara?

A e lejon Islami planifikimin familjar apo jo?

Çfarë është planifikimi familjar?

Kontrolli i lindjeve apo parandalimi i shtatzanisë është evident qysh nga koha e lashtësisë. Qysh në kohën e Egjiptit, gratë përdornin mënyra dhe forma të ndryshme për të krijuar ambient jo të përshtatshëm spermicidal. Për gruan si individ, aftësia për të kontrolluar kur dhe nëse ajo ngel shtatzënë, ndikon në aftësinë e saj për të arritur qëllimet e saj dhe në mirëqenien e saj. Zgjedhja e metodës kontraceptive përfshin faktorë të tillë si: sa e lehtë është për t'u përdorur, sigurinë, reziqet, koston dhe rrethanat tjera personale.

Kjo çështje nuk është një problem që tani paraqitet për herë të parë, as ndër ne dhe as në arenën ndërkombëtare. Edhe tek civilizimet e lashta Babilonase, Egjiptiane, Greke etj. ka qenë prezente çështja e shtimit të popullsisë ose moshtimit të saj, ngase mbi këtë bazë vendosej fati dhe e ardhmja e shumë popujve e perandorive.

Por me rritjen e mundësisë së komunikimit midis popujve, e sidomos pasi lufta e ftohtë filloi të zërë vendin e konflikteve midis blloqeve të caktuara në botë, hyri në modë të termave të gazetarisë, diskutimit dhe propagandës, termi “kufizimi i familjes”, term ky i cili ishte paksa i ashpër për të qëndruar para masave të mëdha të njerëzve në mbarë botën pa dallim feje, race a ngjyre. Kjo bëri që strategët të cilët kishin interes nga kjo fushatë të gjejnë një term më të butë për këtë çështje, siç është “planifikimi familjar”.

Nën këtë “simbol” ata organizojnë konferenca me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar; duke i lidhur këto në raste të caktuara edhe me nëntituj tjerë si “të drejtat e gruas” ose “barazia në mes burrave e grave” etj. Është për t’u çuditur fakti se këto në përgjithësi organizohen nga perëndimorët, të njohur për zhvillim të ulët të popullsisë ose shumë të ulët, madje të quajtur banor të vendeve “të plakura” nga popullsia, vende këto ku ky problem vazhdon të mbetet në një kufizim të tejshkajshëm. Pra janë këta që shkojnë në vendet e të ashtëquajtur “botë e tretë” me qëllim që t’u propozojnë edhe atyre për të zvogëluar dhe kufizuar numrin e lindjeve (shtimit të popullsisë) në ato vende. Pra thënë më qartë, botës perëndimore “të zhvilluar” nuk i leverdis që shtete të caktuara në botë të kenë shtim të popullsisë

më tepër sesa kanë nevojë ata, ngase nuk ju hyjnë në punë, “janë tepriçë teknologjike”, “gjendja mund t’u dalë nga kontrolli” etj...!?

Planifikimi familjar i jep te drejtën çifteve dhe individëve të për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjesi distancën dhe kohën e femijeve të tyre, duke patur informacionin dhe mënyrat për ta realizuar këtë.

E drejta për planifikimin familjar mori miratimin zyrtar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara në vitin 1968.

Sot planifikimi familjar shikohet si një e drejtë e njeriut. Njerëzit kanë mundësinë të zgjedhin metodat e shumta të planifikimit familjar. Normalisht femija nuk është pronë private, si makina dhe shtëpia, por është esenca e vazhdimësisë së gjinisë njerëzore. Planifikimi familjar është një mundësi që ndihmon bashkëshortët të vendosin për shpeshësinë dhe diferencën e viteve ndërmjet fëmijëve të tyre. Para viteve ‘90-të, nisur edhe nga kërkesat e komunizmit për shtim të numrit të popullsisë, familja me shtatë anëtarë ishte diçka normale, ndërsa sot në shoqërinë shqiptare nuk ndeshemi më me një realitet të tillë.

Shumë çifte kanë dëshirë të kenë shumë fëmijë, por pamundësinë për këtë dëshirë e lidhin pikërisht me gjendjen ekonomike të familjes. Paçka se lindjen e fëmijëve e konsiderojnë si pjesën më të bukur të një martese dhe rritjen e fëmijëve e vlerësojnë si shumë të rëndësishme. Një studim i kryer pak kohë më parë nga Instituti i Shëndetit Publik tregon se shumica e të intervistuarve kanë dëshirë të kenë sa më shumë fëmijë. Sipas studimit, shumica e grave të intervistuar dëshirojnë të kenë 2-4 fëmijë. Pra, pamundësia e numrit të lartë të fëmijëve lidhet me gjendjen ekonomike dhe me domosdoshmërinë e

sigurimit të kushteve sa më të mira të jetesës për fëmijët dhe gjithë familjen. Kjo është edhe arsyeja kryesore që kushtëzon shumicën e çifteve në vendimin që të bëjnë fëmijë. Përpara vitit 1992, abortet ishin ilegale, ndërkohë që tani ato janë krejt të ligjshme. Rezultoni se po kryhen 40 aborte për 100 lindje të gjalla. Një rezultat ky shumë tronditës.

Pse hezitojnë të kenë fëmijë?

Shumëkush mund të thotë se femija garanton pasardhjen, shëndetin shpirtëror të një familje, pra mban gjallë prindërit në mënyre direkte apo indirekte.... Çuditërisht familjet e pasura bëjnë më pak fëmijë, ndonëse i kanë mundësitë. Ndryshe ndodh me familjet e varfra, të cilat “nuk e vënë shumë ujë në zjar” dhe e mbushin shtëpinë me fëmijë. Studimet tregojnë se arsyeja pse hezitohet të bëhen fëmijë janë kryesisht angazhimet e shumta profesionale dhe përkujdesi ndaj vetvetes për të pasurit dhe mungesa e kushteve ekonomike për të varfërit. Numri i lindjeve në vendin tonë ka ardhur duke u pakësuar vitet e fundit. Kjo për shkak të një mënyre më të mirë të mbrojtjes me të gjitha metodat, por edhe për shkak se para viteve ‘90 ekzistonte ideja e shtimit të popullsisë dhe shtimit të sa më shumë lindjeve. Kështu, studimi tregon se në Shqipëri numri i lindjeve vazhdon të pësojë një ulje të ndjeshme mesatarisht me 5000-7000 lindje më pak në vit, megjithatë Shqipëria vazhdon të ketë nivel të lartë lindshmërie në raport me të dhënat e lindshmërisë në Evropë.

Rëndësia globale e planifikimit familjar qëndron në faktin se:

1. Shpëton jetët e nënave dhe fëmijëve: lindjet e shpeshta, lindjet në moshë të re dhe të femrave në moshë zvogëlojnë gjasat e mbijetesës së nënave dhe fëmijëve. Planifikimi familjar

mund të parandalojë rreth 25% të vdekjeve maternale dhe të foshnjave duke favorizuar intervalet mes lindjeve në së paku tre vite dhe mbajtjen e shtatzënisë në moshën e femrave kur gëzojnë shëndet të plotë gjithsesi duke shmangur shtatzënitë e paplanifikuara.

- Përmirësimi i marrëdhënieve të bashkëshortëve dhe uniteti familjar. Studimet tregojnë se lirimi nga brenga për një shtatzëni të paplanifikuar përmirëson marrëdhëniet mes bashkëshortëve dhe ndihmon në mirëqenien familjare.

Karakteristikat e planifikimit familjar janë:

- Evitoni shtatzëninë e paplanifikuar.
- Lindja e fëmijëve kur bashkëshortët e dëshirojnë.
- Rregullimi i intervaleve ndërmjet lindjeve për të përfituar një hapësirë kohore të përshtatshme.
- Koordinimi i lindjeve në momentin më të mirë në raport me moshën e nënës.

A është planifikimi familjar i lejuar në Islam?

Në disa raste rritja e numrit të anëtarëve të familjes është e duhur, e në veçanti kur dimë se prej qëllimeve esenciale të martesës në Islam është krijimi i familjes. Nuk ka dyshim se martesa posedon një sërë qëllimesh, endërto edhe prehen dhe qetësinë: “Dhe vendosi mes jush dashuri dhe mëshirë.” Dhe thotë: “Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkonit atë që ua ka caktuar Zoti...” (Bekare, 187) Komentatorët e Kur’anit janë të mendimit se fjala “...kërkonit atë që ua ka caktuar Zoti” ka për qëllim fëmijët dhe familjen.

Risku nuk mund të arrihet ndryshe, veçse me zbatimin e ligjeve të Zotit. Është e vërtetë se Zoti ka garantuar risikun, siç thotë edhe Vetë: “Nuk ka anjë gjallesë në tokë që Zoti të mos ia ketë garantuar furnizimin

e saj. Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e ruajtur (Levhi Mahfudh).” Institucioni i martesës dhe dëshira e të pasurit fëmijë ishte traditë e peygamberëve dhe e të dërguarve të zgjedhur nga Zoti. Zoti thotë: “Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësua të kenë gra e fëmijë...” (Rad, 38) Shembulli më i mirë për besimtarët është shembulli i profetit Muhamed a.s., i cili ishte i martuar dhe kishte fëmijë. Këto profetë dhe të dërguar janë njerëz, të cilët çdo musliman duhet t’i marrë si shembull. Zoti xh.sh thotë: “Ata (të dërguarit e përmendur) ishin që Zoti i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim...” Profetët e Zotit janë shembull për t’u ndjekur nga muslimanët dhe nuk janë për t’u pasuar jomuslimanët perëndimorë apo stili i tyre i jetesës, i cili për shkak të shqetësimit për të shijuar jetën e kësaj bote mund të shkurojë gratë nqaqë kanë shumë fëmijë.

Islami e ka ndaluar beqarinë, murgërinë dhe tredhjen për qëllime të tilla. “Profeti a.s nuk inkurajon vetëm martesën, por veçanërisht ai inkurajon martesën me ato gra që janë pjellore dhe lindin shumë. Profeti a.s thotë: *Martohuni me gruan e cila do t’ju dojë dhe e cila do t’ju lindë fëmijë, me të vërtetë unë do të krenohem me numrin tuaj para peygamberëve të tjerë në Ditën e Gjykimit.*

Nga perspektiva islame, fëmijët janë një dhuratë dhe një bekim nga Zoti. Zoti përmend disa nga mirësitë që Ai i ka dhuruar njerëzimit në ajetin vijues: “Zoti krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja fëmijë e nipa dhe ju furnizoi me (ushqime) të mira. A besojnë ata të pavërtetën, e të mirat

e Zotit i mohojnë?” (Nahl, 72) Zoti gjithashtu ka thënë: “Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote.” (Kehf, 46)

Garantuesi i vetëm i vërtetë për të gjithë njerëzit është Zoti. Nëse muslimanët ndjekin atë që Zoti ka caktuar për ta, Ai do të sigurojë për ta. Zoti ka paralajmëruar në lidhje me një fëmijë të vrarë nga frika e varfërisë: “...të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata...” (En’am, 151) Zoti gjithashtu thotë: “Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytnja e tyre është mëkat i madh.” (Isra, 31)

Prandaj, muslimanët nuk duhet të ndërpresin shtatzëninë ose vrasin fëmijët e tyre nga frika e varfërisë. Zoti i furnizon ata.

Nuk është i lejuar miratimi i një ligji, i cili kufizon lirinë e bashkëshortëve për të pasur fëmijë. Është e ndaluar ndërprerja “përgjithmonë” e aftësisë së gruas apo burrit për të bërë fëmijë, nëpërmjet metodave si lidhja e tubave tek gratë apo vazektomia tek burrat. Është e lejuar për të kontrolluar kohën e lindjeve me qëllim të distancimit të dukurive të shtatzënisë ose ta shtyjë atë për një sasi të caktuar kohore, nëse ka ndonjë nevojë, por në bazë të marrëveshjes dhe rënies dakort mes dy bashkëshortëve.

Komenti i një hadithi i cili trajton çështjen e planifikimit familjar

Nga Ebu Seid el-Hudëriu r.a. përcillet se kishte qenë ulur me të Dërguarin e Zotit dhe dikush e pyeti: “O i Dërguari i Zotit! Ne fitojmë robëresha (si plaçkë pas luftës), vlerë që dëshirojmë ta ruajmë (në mënyrë që më vonë të mund t’i shesim). Çfarë mendoni mbi “azlin” (mbrojtja tradicionale)? Ai tha: “Pse ju nuk e bëni këtë?! Në të nuk keni asgjë të keqe. Zoti është Ai që cakton

se cili shpirt njerëzor do të lindë." Komenti: Nga hadithi i mësipërm vërehet qartë që bëhet fjalë për planifikimin familjar, si dhe lejimin e praktikimit të azlit) - (mbrojtjes tradicionale, terheqjes).

Imamul Hamejini thotë: "Azli-mund të konsiderohet i ndaluar, atëherë kur ai praktikohet nga frika prej varfërisë, nga frika se nuk do të kemi se me çfarë ta mbajmë familjen, e nëse ky nuk është shkaku i praktikimit të azlit, atëherë nuk është i ndaluar."

Që ta vërtetojmë lejueshmërinë e praktikimit të azlit do të sjellim edhe një hadith dhe atë nga Xhabiri, r.a. që thotë: "E praktikoni azlin në kohën e të Dërguarit të Zotit ndërkohë që shpallej Kur'ani. Po të kishte diçka të keqe në të, ai do të ndalohej me shpallje." (Buhariu dhe Muslimi) Islami anon në numrin e lindjeve, me bekim të pasardhësve djem dhe vajza. Megjithatë, kurpërkëtë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe nevoja të vërteta, Islami u lejon muslimanëve planifikimin e lindjeve. Zoti i Madhërisëm në Kuran thotë: "Zoti me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju." (Bekare, 185). Këtu mund të numërohet edhe frika nga përkeqësimi i shëndetit të fëmijës ose rënia e sjelljes morale të tyre. Shumica e dijetarëve islamë pohojnë që për praktikimin e azlit (tërheqjes tradicionale) duhet pëlqimi i bashkëshortes, duke u mbështetur në hadithin që e transmeton Ahmed ibn Hanbeli dhe Ibn Maxhe nga Omeri r.a. që thotë: "Pejgamberi e ka ndaluar praktikimin e azlit me gruan e kurorëzuar, përveç se me pëlqimin e saj." Sot kemi mjete të ndryshme kontrceptive, të cilat bien në kategorinë e dispozitës së azlit. (mbrojtjes nëpërmjet terheqjes) Dallimi midis mjeteve kontrceptive dhe abortuese është shumë i madh. Mjetet kontrceptive janë ato që

pengojnë prekjen, domethënë bashkimin e spermës me mashkullit me qelizën vezë të femrës. Këto mjete konsiderohen njësoj si dispozita e azlit, domethënë janë të lejuara. Nga ana tjetër, mjetet abortuese janë ato që e mbysin jetën e filluar, qoftë menjëherë pas bashkimit të spermës së mashkullit me qelizën vezë të femrës, ose edhe pas camuajsh, kur fetusu ka filluar të formohet. Mjetet të tilla janë të ndaluara rreptësisht, sepse Islami nuk lejon ndërprerjen e dhunshme të shtatzënisë pasi ajo ka ndodhur. Edhe imam Gazaliu bën një dallim të qartë midis kontrceptionit dhe abortimit, duke thënë: "Kontrceptioni nuk është i njëjtë me abortin dhe mbytnjen e fëmijëve të porsalindur. Aborti është akt kriminal kundër një qenie të gjallë. Për shkak se qenia e mbarësuar kalon nëpër disa faza. Faza e parë është të hedhurit e spermës së mashkullit në mitër. Pas kësaj, kjo përzierje është e gatshme të pranojë jetë. Ndërprerja e kësaj jete është akt kriminal. Kur kjo qenie të zhvillohet më tutje, ajo bëhet gjak i ngjizur (alek) i ngjitur në mitër dhe aborti në këtë rast është akti kriminal edhe më i madh. Dhe kur kjo qenie të pranojë shpirtin dhe formimi i saj të plotësohet, atëherë edhe më shumë rritet shkalla e krimit, ndërsa kur kjo qenie të shpëputet e gjallë prej nënës, në qoftë se atëherë ajo hidhet, krimi konsiderohet maksimalisht serioz."

Metodat e planifikimit familjar

Ka 2 lloje metodash të planifikimit familjar: 1. metodat permanente 2. metodat e përkohshme.

(1) **Metodat e përhershme:** Këto metoda përfshijnë vazektominë tek burrat dhe lidhjen e tubave tek gratë. Nga pikpamja e përgjithshme këto 2 metoda janë ndaluar nga shumica e dijetarëve. Zoti xh.sh thotë:

"Përqëndro vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e Zotit në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Zoti, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Rum, 30)

Metoda kontrceptive që ishte i njohur në kohën e Profetit a.s, të cilin e praktikonte vetë Profeti a.s dhe shokët e tij ishte ndërprerja e aktit seksual apo ashtu quajtur ndryshe azli (tërheqja e burrit). Sterilizimi i burrit (vazektomia) apo i gruas (lidhja e tubave) nuk është e lejuar, përveç se në rastet kur është bërë absolutisht e nevojshme për arsye mjekësore. Në rastin e sterilizimit ajo që duhet të shikohet është efekti i shtatzënisë në shëndetin e nënës. Nëse një mjek kompetent përcakton se çdo shtatzani e mundshme paraqet një kërcënim real për jetën e nënës apo të shkaktojë rrezik serioz për shëndetin e saj dhe metodat e tjera kontrceptive mund të kenë një ndikim negativ në shëndetin e saj, atëherë gruaja mund të bëjë një operacion të fillë pa asnjë brejtje të ndërgjegjes. Sterilizimi i cili në vetvete përfshin një operacion kirurgjik është një rast i veçantë. Ndryshe nga metodat e tjera kontrceptive është e përhershme. Për këtë arsye ajo duhet të shihet veçmas. Kjo për sa i përket planit individual. Nga ana tjetër një politikë kombëtare për planifikimin e familjes, e cila ka si qëllim reduktimin e popullsisë është e papranueshme, sepse ajo ka të ngjarë të ketë zbrapsje serioze në shëndetin e popullit si një i tërë.

Nëse ju mendoni se mund ta planifikoni më mirë familjen tuaj, zgjedhja është e juaja ose po të doni lereni në dorë të Zotit të bëjë planifikimin më të mirë për familjen tuaj.

Gjithçka që dua...



nga: Shehide Vojvoda

Posavintemarsitë gjithë fëmijët e lagjes sime bëheshin gatipërtëblerë dhuratapër nënën, sepse duhej ta gëzonin atë për festën e saj... ndërsa nëna ime gjithnjë më thoshte: Më mjafton dashuria që ke për mua, ti vet je dhëurata më e mirë që kam marrë ndonjëherë" Unë si fëmijë nuk kuptoja çfarë ishte rëndësia e kësaj feste, por më flinte në shpirt ajo që nëna ime nuk kishte nevojë për dhuratë materiale, fëmijët e saj ishin dhurata më e mirë për të. Kjo ishte e natyrshme për një nënë, por më vriste kureshtja për nënat e mikeve të mija! çfarë kishin ato në mendje? Me kalimin e viteve po kalonin edhe marse të shumta dhe atmosfera e 8 marsit ishte gjithnjë e njëjtë, shihje fëmije me lule në dore andej e këndeje lagjes.

Ndryshe nga fëmijët e lagjes sime unë çdo ditë të jetës sime kur shkoja në shkollë dhe kthehesha nga shkolla e puthja nënën time në ballë dhe i thoja se e dua shumë e shpeshherë ndodhte të këpusja ndonjë trëndafil nga kopshti dhe të ja dhuroj nënës sime së bashku me puthjen që e merrte çdo ditë. . . Në thellësinë e saj kjo i mjaftonte, buzëqeshte shumë kur i dhuroja dhe lulen madje shpesh me thoshte e këpute dhe një sot ë? Nesër do bëhet më e bukur...!

Një ditë më kapi kureshtja të di se çfarë është në fakt 8 marsi dhe mora të hulumtoj.

Pashë këtë shkrim:

"8 marsi është dita ndërkombëtare e grave. Kjo ditë festohet në shumë vende të botës. Dita ndërkombëtare e grave është historia e grave të zakonshme që kanë bërë histori. Kjo ditë është rrënjësore si luftë shekullore e grave për të marrë pjesë në shoqëri në nivel të barabartë me burrat. Ideja e ditës ndërkombëtare të grave erdhi në fillim të shekullit 20... ". Çudi thashë me vete, dita kur grave u dhanë disa "të drejta"

Për çfarë të drejtash po flitet këtu?!

Këto të drejta edhe shumë më shumë se kaq femrave myslimane u janë dhënë 14 shekuj më parë...! Zoti i Madhëruar ju dha të drejta të shumta, ua bëri të tyre çdo ditë të jetës, ndërsa ato injorojnë këtë dhe gëzohen për një ditë të vetme në vit?! Ndërsa viti ka 365 ditë?! Nuk po kuptoj gjë thashë me vete!

Ndërsa, kush guxon ta nënvlerësoj femrën, kur Allahu e ka lartësuar atë?! Femrën e bëri vajzë, e bëri motër, e bëri grua, e bëri nënë, gjyshe, edukatore. Madje i dha rëndësinë më të madhe si nënë. Kur u pyet i Dërguari i Zotit Muhamedi se kush nga prindërit e meriton respektin më të madh ai tha: nëna! Po pastaj o i Dërguar? Tha nëna! Po pastaj? Tha nëna! Po pastaj o i Dërguar i Allahut? Tha pastaj babai! Sikur dikush të më thotë se më do vetëm më 8 mars, më jep dhuratë vetëm më 8 mars, më vlerëson si femër vetëm atë ditë, do ndjehesha e poshtëruar, kjo qenka poshtërsia më e madhe për një grua...!

E shqetësuar me këtë dola në kopsht të nëna ime, si zakonisht e putha në ballë dhe i thashë se e dua shumë!

Dua të të bëj një pyetje moj nënë - i thashë? Urdhëro moj drita ime - u përgjigj ajo!

Pse ti kurrë nuk deshe të të blej dhuratë për 8 mars?!

Atëherë ajo qeshi me zërin e saj të ëmbël dhe më tha:

Bija ime, ti dhe vëllezërit e tu jeni drita e jetës sime, unë falënderoj Zotin që më dha një familje të tillë. Ju jeni dhuratë më e mirë që unë dhe babai yt kemi marrë nga i Madhi Zot. Ju jeni ata që ma ndriçoni çdo ditë të jetës sime. Ti je ajo që më puth dhe më thua se më do shumë çdo ditë kur nisesha për në

shkolle dhe kur kthehesha nga shkolla, unë tërë ditën rri e kënaqur me këto fjalë, madje të njëjtën gjë pa e vërejtur si të veçantë ti e bën edhe çdo 8 mars si një ditë e zakonshme për ne.

Më thuaj bija ime, sikur ti këtë ta bëje vetëm më 8 mars çfarë do të bëja unë pa përqafimin dhe fjalën tënde të ëmbël 364 ditë?! Nëse njerëzit e mi të dashur nuk ma japin atë që e meritoj çdo ditë të jetës sime ç'më duhet 1 ditë në vit?! Unë marr dhuratë nga ju e përqafime çdo ditë, pra çdo ditë në mënyrën e saj është e veçantë për mua falënderimi i takon Zotit. Atëherë unë u ula te këmbët e saj i putha të dy duart dhe i thashë:

Nëna ime falënderimi i takon Zotit që më ka dhuruar një nënë të tillë, një nënë që di të jetë shembull për mua, një nënë që më mbush plot jetë me këshillat dhe fjalët e saj të ëmbla. Ti, nëna ime meriton shumë më shumë se sa të ofroj unë. Nën këmbët e tua është Xhenneti im... Unë nëna ime të dua aq shumë dhe të jam mirënjohëse që më edukove në frymën islame, sepse sikur ndonjëherë ta kisha veçuar këtë ditë për ty sot nuk do gjeja fjalë për të të kërkuar falje...! Unë e dua çdo nënë dhe çdo femër, prandaj ju drejtohem me këto fjalë: O Nëna dhe motra juve që Zoti ju bëri margaritarë mos e nënvlerësoni veten, mos i lëni anash privilegjet që ju dhanë, mos e kufizoni vetën në një ditë. Zoti ju dha të drejta çdo ditë të jetës suaj. Ngrijeni zërin dhe kërkonin atë që e meritoni në të vërtetë. Ai që ua mori 364 ditë e ua dha vetëm një nuk ju do, ai ju nënvlerëson mos i buzëqeshni. Mbështetuni Atij që ju do dhe ju ngriti aq lart, jini falënderuese ndaj Zotit, krijuesit të margaritarëve që shpesh dëshironi t'ju ngjani...

Falënderimi i takon Allahut që ma mundësoi ta bëjë këtë shkrim deri në fund dhe ta ndaj me ju nëna dhe motra të dashura që ju dua shumë për hir të Zotit. . . Pastaj falënderoj nënën time për këshillat dhe edukatën që më dha, ajo meriton dashurinë dhe respektin tim çdo ditë të jetës.

Ajo është margaritari i shtëpisë sime. . .

Paqe dhe mirësi për nënën time dhe për çdo nënë. . .



Një fjali depërtoi thellë në veshët e mi dhe ma ndau zemrën.

"Fëmija juaj ka ndërprerë zhvillimin e tij ose me saktë fëmija i juaj ka vdekur. I gjithë trupi mu drodh nga ankthi, ëndrrat sikur mu shuan dhe zemra mu copëtua. Valle çfarë po thotë ky doktor me këto fjalë, -pyesja veten. Pse po mi thotë mua ndërkohë që unë jam shumë mirë. Po une pse po ndjeja kaq frikë, çfarë po ndodhte kështu. A vërtet nuk po e kuptoja doktorin apo unë nuk doja ta besoja atë çfarë po me ndodhte. Duke parë gjendjen time, doktorin më përsëriti: "fëmija juaj ka vdekur tashmë. Si rrufe u ngrita nga shtrati dhe dola nga dhoma e spitalit. E gjeta veten tek një lulishte duke menduar çfarë po më ndodhte mua. Në vesh kasha fjalët e doktorit tek na ngushëllonte: "Mos u mërzisni, ju jeni të rinj dhe do keni fëmijë të tjerë. Nuk mundesha të besoja këtë të vërtetë dhe ngushëlloja veten se mos ka gabuar doktorin, me siguri nuk ishin për mua ato fjalë. Ndoshta aparati nuk ka qenë në reëgull dhe nuk e ka dëgjuar mirë zemrën e foshnjës sime. Unë po e dëgjoj shumë mirë!

Duhet ti thoja STOP vetes dhe të pranoja realitetin sado i dhëmbshëm që ishte. Tani në bark po mbaja një fëmijë të pa jetë. Madje dhe pas lajmit e mbajta në bark për afër tre ditë dhe mu desh të flisja me të edhe pse nuk më dëgjonte se me duhej të ndahesha nga ai. Zemra nuk ma bënte të largohesha për as një sekondë. Isha e gatshme ta mbaja në bark edhe të pa jetë.

Tik-taket e orës u ndalën. Një rebesh shiu ra mbi faqet e mia. Doktorin me fytyrë të ngrysur po afrohej drejt meje për të më dhënë lajmin më të hidhur të jetës sime. Me ankth po prisja se çfarë do të nxirte nga buzët e çfarë kishte ndodhur që fytyra e tij ishte e ngrysur. Dhe ja ku doktorin foli:

- Zonjë, ne bëmë gjithçka mundëm, përdorëm të gjitha forcat tona por kur është e shkruar diçka - sic edhe ju e thoni, ne nuk e ndalojme dot. Isha shumë e hutuar, zemra me rrihte fort: asnjë fjalë nuk kuptova nga ato që doktorin po më thoshte. Ai vazhonte dhe fliste e fliste, dhe unë me atë hutinë time e shihja doktorin në sy duke i thënë me shikimin tim: doktor të lutem përsërite dhe një herë çfarë thatë.

Një nënë nuk duhet ta lërë birin e saj vetëm, nuk doja të me ndanin nga ai, sepse ishte foshnja ime ishte ajka e zemrës sime, drita e syve të mi, ishte bota për mua.

Çfarë nuk do të jepja të dëgjoja të qarën e parë të një fëmije që ishte pjesë e trupit tim kur e pashe të shtrirë në një tryezë druri. Por jo, i shtrenjti im po flinte mbi atë tryezë që nuk do të zgjohesha kurrë. Unë rrija dhe e vështroja me sytë mbushur me lotët e një nëne që qante nga përmallimi për të birin e saj të vetëm.

E kapa në dorë, e putha fort dhe i pëshperita në vesh biri im në jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehem një ditë, ndaj mos u merzit se mami yt se shpejti do të jetë

me ty në një botë tjetër. Në atë botë ku nuk ka dhembje dhe vuajtje, por begati dhe mirësi të përjetshme për ata të cilët besuan punuan dhe duruan. Zoti thotë në Kuran: "Përgëzoji ata të cilët thanë: "Të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehem kur Zoti i sprovoi me frytet e kësaj bote. Dashuria që kisha për këtë fëmijë më dha forcë dhe vullnet për të ecur përpara. Duke shpresuar se Zoti do të më bashkojë sërish me të në parajsë ku do mundem ta mar në krah, ta puth e përqafoj e t'i dëgjoj zërin që kurrë nuk ia dëgjova. Edhe pse asnjëherë nuk më thërriti, ky fëmijë më vuri emrin më të shtrenjtë në botë, emrin NENE.

Dashuria e një nëne për fëmijën e saj as nuk mund të shkruhet dhe as nuk mund të lexohet ajo ndjehet dhe përjetohet.

Kjo është një pyetje që e dëgjon nga hedh këmbët nëpër qytetet tona që duket sikur i kanë harruar të gjitha hallat e tjera dhe janë mpleksur me "hallat" a banorëve të mbërthyer në një shtëpi ku më së shumti thërret për antivlera dhe intrigë romaneske se sa për aq sa shumica e mendon si bashkejtesë e thjeshtë tremujore. Kudo ku flitet në stade më të larta se kaq, flitet dhe madje proklamohet me të lartë vlera e këtij shekulli të ri që medoemos do të na bëjë anëtarë të një bashkësie vlerash e integriteti njerëzor, por jo. Si në çdo hap tjetër jemi ne ata që rrëzojmë vetet tona aty ku nuk do mund të ngrihemi më. Tek flet për vlera duket si kur i bën morale e morale pafund rinisë dhe pleqërisë së kujtdo rangu, por e vërteta është se pikërisht emisione dhe shtysa të tilla jo vetëm po e çorientojnë "rininë" dhe "pleqërinë" tonë, por po mbjellin situata dhe risi të paqëna në asnjë vend të botës që diku shumë para nesh i ka shpikur këto metoda perverse dëfrimi.

Ajo që më bëri të reagoje ndaj këtyre "spektakleve" që sjellin vetëm degjenerim dhe japin një mesazh të keq për rininë shqiptare në përgjithësi nuk janë ata njerëz që mbyllen në ato shtëpi "publike", por më shumë më iritoi paraqitja publike e prindërve të tyre që krenohen me femijet e tyre të degjeneruar që padyshim janë pasqyrë e tyre dhe më pas paraqitja e mysafirëve të ndryshëm që vijnë në emision për të komentuar në cilësinë e "analisteve" që t'i analizojnë veprimet dhe preferencat e tyre seksuale.

Kur u shfaq një të dielë spektakli "Big Brother" ku ishin të ftuar edhe dy ambasadorë, njëri që përfaqësonte Amerikën dhe tjetri Evropën kushtimisht si duket këta ambasadorë merrnin pjesë për ta promovuar homoseksualizmin në Shqipëri dhe të drejtën e të rinjve shqiptarë për t'u deklaruar lirshëm për orientimin e tyre seksual. Nuk na befaso prania e ambasadorit holandez që kishte ardhur për ta promovuar homoseksualizmin e njërit prej anëtarëve të Big Brother) në Shqipëri si një standard që duhet plotësuar ndoshta për të hyrë në Evropë sepse dihet se ne vendin e tij ka më shumë homo se heteroseksual por më befaso prania e ambasadorit amerikanit dhe komentet e tij për këtë fenomen, kur dihet se ata janë më fanatikë në këtë çështje sesa evropianët në përgjithësi.

Kulmi i degjenerimit ishte kur paraqitet nëna shqiptare që kishte përjetuar kohën e diktaturës (ku nuk kishte as bukë elbi të mjaftueshme) duke e mbrojtur djalin e saj për homoseksualizmin e tij dhe ajo nena tjetër shqiptare-kosovare, kur e ngushellon të bijën e saj gjysëm lakuriq që puthej me njerin prej banorëve para 7 milion shqiptarëve që të mos mërzhitet se tashmë e ka babain e saj këtu në Tiranë. I cili ka ardhur për të bërë doktoraturën në Shqipëri. E mund ta marrim me mend se si mund t'i edukojë nesër ai doktor vajzat tona nëse i jepet rasti të punojë në arsim. Apo rasti i një këngëtareje që festonte ditëlindjen e qenit të saj publikisht në "Shpine e Kosovës" në kohën kur më shumë se gjysma e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë me se të ushqehen.

Mos të harrojmë se me nivelin ekonomik dhe zhvillimor që ka Kosova dhe Shqipëria mund të krahasohen me ato shtetet e Afrikës subsahariane sepse tjetër shembull në Evropë nuk ka, kurse me lakuriqësi dhe veprime degjeneruese e kemi kaluar perëndimin për shumë e shumë herë.

Ndaj edhe është e artë fjala e profetit të fundit ku thotë:

"Tri gjërave iu druham për pasuesit e mi: shmangies nga dituria, joshjeve devijuese dhe epshit të stomakut dhe pjesëve intime."

M.c

IMORALITETI KULTUROR NË SPEKTAKLIN E "TE SHTUNES" E "TE SHTUNES"

Ç'bëhet në Big Brother dhe Shtëpia e Kosovës?

Zgjahemi me agimin e shohim
fushat, malet e yjet
por, se kush i krijoi askush nuk pyet
vazhdojmë rrugën pa ditur se ku po shkojmë
dhe zërin e së vërtetës aspak se dëgjojmë

Një ndërtesë duhet dikush për ta ndërtuar
po ky univers vetëvetiu është krijuar?!
Zhytmi pas dynjasë, pas luksit e parasë
duke harruar se çdo të vijë më pas...

Jeta është si lumë që shkon për t'u freskuar
por të merr në thellësi krejt pa e kuptuar
Por, Zoti ka dërguar libra e profetë
që ne të jetojmë jetën e vërtetë.

Një shkrim
i një vajze të vogël
me mirësi të mëdha...

Art grafika:
Ornela Bitia

BASHKËPUNËTORË:

ELSA XHAJ - gazetare - Kryetare e Shoq. "Gruaja në media"
SHEGA MURATI - Kryetare e Shoq. "Zëri i fëmijëve na thërret"
JULIANA AJDINI, Prof. Fakulteti Shkencave Sociale.
A. KALAJA - teolog, G. LECINI - gazetar

© Të gjitha materialet e botuara në revistë janë të rezervuara për botuesin e "Përtej fjalës".
Nuk lejohet përdorimi, riprodhimi apo publikimi i tyre pa lejen e botuesit.

Shtypi: "Ilir"

KËSHILLI I REDAKSISË:

ADELINA KASEMI;
ERIONA KODRAGJINI;
ENTELE HIDRI;
RMIDA PLUMBI;
ENKELEDA RROSHI;
EDLIRA DURMISHI.

Pikpamiet e paraqitura
në revistë nuk shprehin
domosdoshmërisht
pikëpamjet e revistës.

Mirëpresim sugjerimet
tua, idetë e opinionet
pranë adresës sonë:

e-mail: përtej_fjalës@gmail.com

*Një Zot , Ai i Vetëm, botën e krijoi
Për gjashtë ditë me rradhë dhe mbi arsh qëndroi.
Krijoi 7 palë tokë, po aq dhe qiej
qiellin më të afërt, me yje e zbukuroi.*

*Krijoi fusha, male, dete dhe oqeanë
Lumenj e burime, madhështi pa fjalë
Krijoi diell, hënë, vite, muaj, javë
Ndër ta katër stinë, dimër dhe beharë*

*Krijoi Ademën, babanë e njerëzimit
Më pas krijoi Havanë, nga pjesa e tij e brinjës
Dhe nga ai burrë, e grua, lindën plot mirësi
U bënë fis e kombe ngjyra, plot larini
Veç ngjyra para Zotit, ajo nuk ka rëndësi
Të gjithë të barabartë, do jemi para Tij.*

*Krijoi lindje, vdekje, fillim edhe mbarim
Në "librin e sigurtë", çdo gjë është shënim
Ndalimi hapin njerëz, për pak meditoni
Hidhni një vështrim, natën e shikoni?*

*Mos vallë ju duket ende, gjithë kjo një rastësi!
Çdo gjë e krijuar, nga Ai që gjithëka di
E gjithëka që shihni, në qiell, tokë e det
E madhëron Krijuesin me gjuhën e vet
Veç juve ndër krijesa ju dha mendje e logjikë
Mbi çdo gjallesë ju ka lartësuar
ç'argument kërkoni, për ta adhuruar?*

*A mos prisni qiellin të bie copa-copa
A mos prisni diellin, të lindë nga perëndon?
Atëherë për çdo njeri do jetë shumë, shumë..... vonë...*

*Shkroi: Armela Hoshja
Medreseja e Tiranës*